

9/5.

15.01.20.



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave
në “Informatikë Ekonomike” me profile “Financë
Bankë”, “Administrim Biznesi”
“Universiteti European i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Arbana Kadriu

Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli

Janar 2020

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES VLERËSIMI TË JASHTËM

Programi i ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave 'Informatikë Ekonomike' me profile "Financë Bankë", "Administrim Biznesi", ofruar nga Universiteti European i Tiranës është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Nr. 452, datë 14.09.2011. Programi i studimit realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademik (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master i Shkencave" në "Informatikë Ekonomike", në profilet: a) Financë Bankë; b) Administrim Biznesi.

Programi është akredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 54, date 06.02.2013 me afat 6 vjeçar, deri në 05 shkurt 2019.

Brezi i fundit i studentëve të regjistruar në këtë program ka qenë në vitin akademik 2017-2018, sepse ky program është mbyllur tashmë. Arsyeja e mbylljes është riorganizimi i tij në një program studimi me 5 profile. Gjenerata e fundit e studentëve është ajo e vitit akademik 2018-2019 (viti i II) dhe ka pasur 84 studentë të regjistruar. Ky program nuk është ofruar për vitin akademik 2019-2020.

Programi është ofruar deri në vitin akademik 2017-2018 nga Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Statistikës (Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit). Me ndryshimin e strukturës së IAL në vitin akademik 2018-2019, programi i studimit u ofrua nga Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë (Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës); dhe nga viti akademik 2019-2020, ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, njësi në Fakultetin e Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit.

Ky raport i përgatitur nga ana e Grupi të Vlersimit të Jashtëm ka për qëllim vlerësimin në kuadër të ri-akreditimit për programin e studimit Master i Shkencave 'Informatikë Ekonomike' me profile "Financë Bankë", "Administrim Biznesi" vetëm për studentët që diplomohen në vitin 2019 dhe/ose studentët e mbartur që akoma nuk kanë përfunduar studimet, në brezat e mëparshëm.

Për programin e studimit Master i Shkencave në "Informatikë Ekonomike, me profile: Financë dhe Bankë; Administrim Biznesi" në Vendimin e tij nr. 423, datë 11.01.2013, Këshilli i Akreditimit rekomandon:

- Të realizohen studime tregu bazuar në metoda dhe instrumenta të provuara për të identifikuar pritshmëritë e punëdhënësve për aftësitë që studentët duhet të zotërojnë në përfundim të studimeve në e studimit Master i Shkencave në "Informatikë Ekonomike"
- Të krijohen mekanizma për nxitjen dhe përfshirjen e studentëve në mënyrë individuale ose në bashkëpunim me pedagogët në kërkime të mirëfillta shkencore.
- Të implementohet një sistem i qendërzuar për automatizimin e menaxhimit të studentëve dhe personelit.
- Të pasurohet faqja e internetit me të dhëna mbi procesin dhe rezultatet e akreditimit të institucionit dhe programeve mësimore.

Sic përshkruhet edhe në këtë RVJ, UET ka marrë masat e nevojshme për plotësimin e këtyre rekomandimeve.

GVJ ka listuar pikat e forta dhe të dobëta sipas kërkesave të ASCAL dhe rekomandimet që jepen në këtë raport janë për t'u konsideruar nëse rihapet programi Master i Shkencave në "Informatikë ekonomike".

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Raporti i vlerësimit të jashtëmësthtëpërgatitur nga Prof As. Arbana Kadriu dhe Prof As. Ezmolda Barolli të përcaktuar si ekspertë të jashtëm me Urdhër të Agjensisë për Sigurimine Cilësisë në Arsimin e Lartë, Nr. 83, datë 16.10.2019 me qëllim vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin e programit Master i Shkencave “Informatikë Ekonomike”, me profile “Financë Bankë”, “Administrim Biznesi”, në Institucionin e Arsimit të Lartë “Universiteti Europian i Tiranës”.

Grupit të vlerësimit të jashtëm (me tej GVJ) iu vendosën në dispozicion 132 dokumente të përgatitura nga institucioni, të cilat ishin mjaft ndihmuese në funksion të detyrës që iu caktua. Me datë 13 dhe 14 Nëntor 2019 u realizua edhe vizitë dy ditore në institucion, ku GVJ takoi dhe diskutoi me përfaqësues të zyrave relevante për programin e studimit.

Vlerësimi i programit u përqëndrua në analizë të përmbajtjes së kurrikulës dhe lëndëve, shpërndarjes së krediteve dhe orëve, literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik për lëndët që ligjërojnë, sigurimit të cilësisë, mobilitetit të studentëve dhe personelit akademik, bashkëpunimin me kompanitë e biznesit etj.

Ky raport paraqet vlerësimin e bërë për programin nga ana e GVJ në bazë të dokumentacionit që është dorëzuar, raportit të vlerësimit të brendshëm, materialeve që janë kërkuar gjatë vizitës në institucion dhe intervistave me personelin akademik, personelin administrativ dhe studentët.

Koordinator teknik i ASCAL gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm është ME. Renata Qatipi.

Më datë 10.01.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 9/2 Prot., “Njoftim për dërgimin e Draft - Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, Universiteti Europian i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

UET përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft-Raportin, përmes sistemit AMS dhe me shkresë Nr. 06/2 Prot., datë 14.01.2020 “Dërgohen përgjigje për draft raportin e vlerësimit të jashtëm për programin e studimit Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike, me profile: Administrim Biznesi, Financë Bankë””. Në këtë dokument institucioni deklaron që nuk ka komente për Draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm.

Draft Raporti kthehet në Raport përfundimtar.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Informatikë Ekonomike" me profile "Financë Bankë", "Administrim Biznesi"

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi "Master i shkencave"/"Master i arteve", në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi "Master i shkencave"/"Master i arteve" që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	GVJ mendon se Programi i Studimit "Master i Shkencave" në "Informatikë Ekonomike" me profile "Financë Bankë" dhe "Administrim Biznesi" është ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë UET në përputhje me interesat kombëtare, e shprehur kjo në vizionin e institucionit (Plani Strategjik 2015 - 2020) , sipas të cilit UET synon të jetë një universitet lider për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare, do të punojë në përputhje me modelin sipas së cilit arsimi i lartë ka një rol parësor e unik në përmirësimin e kohezionit social të një vendi, ku universitetet janë në linjën e parë të respektimit të kodeve të sjelljes së mirë në të gjitha fushat.
Kriteri 2. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Duke u mbështetur tek dokumentat strategjike GVJ mendon se ky program studimi ka mbështetur ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Sipas Planit Strategjik 2015 – 2020, UET ka vendosur tek prioritetet në bashkëpunimin dhe kooperimin ndërkombëtar, që të bëhet njëqëndër e rëndësishme dhe pikëreferimi kombëtar e rajonale në kooperimin akademik universitar, kërkimin shkencor, aktivitetin botues, dhe promovimin e vlerave zhvilluese e qytetare të arsimit të lartë.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Duke u mbështetur tek RVB si dhe dokumentat e vëna në dispozicion, GVJ mendon se ky program studimi është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, i cili synon t'u japë studentëve një edukim cilësor, duke përthyer në të rezultatet e një kërkimi shkencor të vlefshëm, t'i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, përdorimit të arritjeve më të mira të shkencës, si dhe partneriteteve në tregun e punës e atyre ndërkombëtare (Statuti i UET, Kreu 1, Neni 6). Sipas planit strategjik për zhvillimin e programit, objektivi kryesor i Programit të Studimit "Master i Shkencave" në "Informatikë Ekonomike", me profile "Financë Bankë" dhe "Administrim Biznesi" është të pajisë studentët me njohuri të gjera rreth sistemeve të ndryshme të informacionit që mbështesin proceset e biznesit, ekonomisë dhe mbi aspekte specifike të tyre si siguria, pavarësia nga vendndodhja (p.sh. në aplikime mobile), etj. Qëllimi i tij është të përgatisë specialistë të pajisur me njohuri mbi teknologjitë e fundit informatike që mund të mbështesin shumë procese biznesi.
Kriteri 4. Programi i studimit "Master	GVJ në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe RVB konstaton

<p>i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>se nëpërmjet këtij programi UET ka synuar të plotësojë kërkesat e tregut të punës për specialistë të cilët zotërojnë kapacitetet dhe janë të aftë të shfrytëzojnë mundësitë që ofron teknologjia në funksion të zhvillimit të biznesit.</p> <p>Mbledhjet që zhvillohen me Bordin e Tregut të Punës si dhe studimet që ka bërë UET mbi kërkesat e tregut në këtë drejtim, kanë ndihmuar në përputhshmërinë e këtij programi me nevojat e tregut të punës.</p> <p>Gjithashtu Projekti 250+ që përfshin 250 kompanitë më të mëdha në vend është një projekt i gjerë bashkëpunimi 5 vjeçar që ka si qëllim thellimin dhematerializimin e kooperimit me biznesin në vend, sidhe bashkëpunimin me këto kompani duke i pasur ato prioritare për të integruar studentët në internships dhe deri nëpunësimin e tyre.</p>			
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>Në mbështetje të statutit të UET, kreu 4 neni 32 ky program studimi u hartua për të pajisur të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si dhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Ai është realizuar në 120 kredite. Në bazë të nenit 33 kreu 4 pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë fituar diplomën “Master i Shkencave”.</p> <p>GVJ në bazë të dokumentave të paraqitura nga institucioni është i mendimit se ky program studimi në një pjesë të konsiderueshme ka ofruar njohuri të thelluara studentëve të diplomuar dhe jep atyre mundësinë të jenë kandidatë për studime të thelluara të ciklit të tretë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.2 Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Duke u mbështetur tek dokumentacioni i vënë në dispozicion (Prioritetet- Plani Strategjik 2015–2020; Projektet Kërkimore-Strategjia e Kërkimit Shkencor në UET (2017-2020); Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit) GVJ mendon se organizimi i programit të studimit “Master i Shkencave” në “Informatikë Ekonomike” me profile “Financë Bankë” dhe “Administrim Biznesi”ka qenë në përputhje me objektivat strategjike të UET për ekselencë në fushat e aktiviteteve akademike dhe të kërkimit shkencor dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në</p>	<p>Duke u mbështetur tek dokumentacioni i vënë në dispozicion (Prioritetet- Plani Strategjik 2015–2020) UET synon ndërtimin e të gjitha kurrikulave të tij në përputhje me eksperiencën më të mirë të universiteteve perëndimore, kërkesave të “Kartës së Bolonjës”,</p>

zbatim të këtyre të fundit.	<p>përshtatjen e tyre me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet e tregut, mundësinë përvetsimit sa më të mirë të tyre, etj. Këtë gjë UET e mbështet me anë të realizimit të Objektivave Strategjike (Statuti i UET Neni 6).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion dhe në bazë të dokumentave të tjera të këtij programi studimi, GVJ konstatoi se ky program studimi është ofruar në përputhje me këto prioritete.</p>			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	<p>GVJ është i mendimit se emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e këtij programi studimi në pjesën më të madhe ka qenë në përputhje me fushat e drejtimet akademike të UET të shprehura në Objektivat Strategjike (Plani Strategjik 2015 – 2020), sipas të cilave UET synon profilizimin e universitetit si një “universiteti biznesit”, duke i dhënë përparësi ndërtimit të kurrikulumeve, strukturës së programeve e diversitetit të diplomave e profileve në funksion të kërkesave të tregut të punës në nivel kombëtar e rajonal. UET synon ruajtjen e profilizimit të tij kryesor në shkencat ekonomike, financiare, menaxheriale, jurisprudencës, shkencave politike e sociale, edukimit, TI, komunikimit, etj.</p>			
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit	<p>Ekonomia shqiptare, e cila është pjesë e ekonomisë globale nuk bën përjashtim nga tendencat e sotme të zhvillimit, ku teknologjia është integruar në të gjitha fushat e ekonomisë. Për të qenë në koherencë me këto tendenca programi i studimit “Master i Shkencave” në “Informatikë Ekonomike” me profile “Financë Bankë” dhe “Administrim Biznesi”, ka synuar të pajisë studentët me njohuri të gjera rreth sistemeve të ndryshme të informacionit që mbështesin proceset e biznesit, ekonomisë si dhe mbi aspekte specifike të tyre si siguria, pavarësia nga vendndodhja, etj.</p> <p>GVJ është i mendimit se hartimi i këtij programi studimi ka qenë në të njëjtën linjë me trendet kombëtare dhe globale të zhvillimit të ekonomisë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që	Sipas Planit Strategjik për Zhvillimin e Programit, objektivi kryesor i programit të studimit “Master i Shkencave” në “Informatikë Ekonomike”, me profile “Financë Bankë” dhe “Administrim Biznesi” ka qenë të pajisë studentët me njohuri të gjera rreth sistemeve të ndryshme të informacionit që mbështesin proceset e biznesit,

<p>duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>ekonomisë si dhe mbi aspekte specifike të tyre si siguria, pavarësia nga vendndodhja, etj. Sipas studimit të UET mbi kërkesat e tregut të punës, ajo që kërkohet sot është specialistë të pajisur me njohuri mbi teknologjitë e fundit informatike që jo vetëm flasin por edhe kuptojnë gjuhën e biznesit.</p> <p>Objektivat Strategjike (Plani Strategjik 2015 – 2020) përcaktojnë profilizimin e UET si një “universitet të biznesit”, duke i dhënë përparësi ndërtimit të kurrikulumeve, strukturës së programeve e diversitetit të diplomave e profileve në funksion të kërkesave të tregut të punës në nivel kombëtar e rajonal.</p> <p>GVJ mendon se një pjesë e madhe e lëndëve të këtij programi studimi i pajisin studentët me njohuri të thelluara shkencore dhe përmbushin objektivat e shprehura më sipër.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion GVJ konstatoi se UET ka zhvilluar një studim të tregut të punës përpara hapjes së këtij programi studimi, i bazuar tek të dhëna të marra nga fokus grupet, intervistat dhe anketimet, mbi bazë të të cilave ka qartësuar elementët bazikë të programit të studimit, emërtimin e programit, profilet, si dhe mundësitë për punësimin e të diplomuarve, etj.</p> <p>Gjithashtu institucioni ka realizuar edhe studime periodike për të diplomuarit dhe të punësuarit sipas profileve të këtij programi studimi, dhe jo vetëm (studimi për të diplomuarit e vitit akademik 2016 – 2017) sipas të cilit 62.5% e të diplomuarve në programin e studimit “Master Shkencor” në “Informatikë Ekonomike”, me profile “Financë Bankë” dhe “Administrim Biznesi” janë punësuar.</p> <p>GVJ është i mendimit se rekomandimi i KA është përmbushur.</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Duke u bazuar tek RVB dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ mendon se objektivat formues, struktura, përmbajtja e programit të studimit, dhe rezultatet e pritshme të të nxënit janë pasqyruar qartë në “Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë, “Master i Shkencave” në “Informatikë Ekonomike”, me profile “Financë Bankë” dhe “Administrim Biznesi”.</p> <p>Nga ana tjetër për të garantuar që dijet e përfituara i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve, institucioni ka kryer takime frekvente ku ka ndarë me ish studentët mendimet mbi përvojat e tyre personale në tregun e punës dhe ka kërkuar sugjerime e përshtypje individuale e në grup për ndryshime, reformime e përmirësime të mundshme.</p> <p>Nga të dhënat e analizuar ndër vite ka rezultuar se pjesa më e madhe e studentëve pjesëmarrës në këto takime punësohen mbas mbarimit të ciklit të dytë të studimeve.</p>

<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Sipas Prioriteteve në Procesin Mësimor të përcaktuara në Planin Strategjik 2015-2020, UET synon ndërtimin e të gjitha kurrikulave të tij në përputhje me eksperiencën më të mirë të universiteteve perëndimore, kërkesave të “Kartës së Bolonjës”, përshtatjen e tyre me ndryshimet social - ekonomike dhe zhvillimet e tregut, mundësinë e përvetsimit sa më të mirë të tyre, etj.</p> <p>Duke u mbështetur tek Plani Mësimor i këtij programi studimi, GVJ mendon se lëndët që janë zhvilluar, orët mësimore përkatëse, numri i krediteve për secilën lëndë, dhe elementë të tjerë që mbështesin programin kanë qenë në një pjesë të madhe të tyre të përafërta me programe studimi të ofruara nga institucione ndërkombëtare.</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvajtjen disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Duke u bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion (Rregullore e UET, Neni 13) dhe tek RVB, GVJ është i mendimit se ky program studimi ka qenë në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p> <p>Gjatë periudhës 8 vjeçare në të cilën është zhvilluar programi i studimit “Master i Shkencave” në “Informatikë Ekonomike” me profile “Financë Bankë” dhe “Administrim Biznesi” studentët dhe pedagogët janë përfshirë në projekte të ndryshme duke përfutur nga praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Sipas planit mësimor ky program studimi ka përfshirë edhe aftësimin profesional nëpërmjet praktikës profesionale e cila zhvillohet në semestrin e II të vitit të II dhe vlerësohet me 12 ECTS dhe me notë, njëjloj si detyrimet e tjera Rregullore e UET, Neni 34).</p> <p>Zhvillimi i praktikave mësimore/internship-eve është bërë i mundur në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit që institucioni ka nënshkruar me organizata të njohura në vend publike apo private, të tilla si Infosoft, We WEB, INSTAT, etj, të cilat i kanë dhënë mundësinë studentëve të aftësohen profesionalisht në përputhje me objektivat e këtij programi.</p>
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimit e institucionit.</p>	<p>Në bazë të Rregullores së UET, Kreu IV Neni 16, përcaktohet që si pjesë e lëndëve të kategorisë C, lëndë ndërdisiplinore / integruese - grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje, departamenti mund të ofrojë lëndë “Honors course”. Këto lëndë propozohen dhe drejtohen nga pedagogë me grada dhe tituj, të cilat mund të ndryshojnë nga njëri vit në tjetrin, në varësi të ekspertizës së personelit akademik të gatshëm për t’i zhvilluar. Këto kurse mund të ofrohen edhe në gjuhën angleze.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua që pavarësisht se në këtë program studimi nuk janë ofruar module, lëndë apo i gjithë programi në gjuhë të huaj, institucioni ka përcaktuar me rregullore që literatura e detyrueshme të jetë jo më pak se 50% në gjuhë të huaj.</p>

	Literatura e detyrueshme në këtë program studimi ka qenë në pjesën më të madhe në gjuhën angleze.			
Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se meqënëse ky program studimi u licensuar në gjuhën shqipe, dokumentacioni i tij gjithashtu është arkivuar në gjuhën shqipe. Megjithatë nga dokumentacionet e vëna në dispozicion dhe bazuar edhe tek RVB, GVJ konstatoi se një pjesë e dokumentacioni të UET gjendet edhe në gjuhën angleze.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Informatikë Ekonomike” me dy profile është ofruar fillimisht nga Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit deri në vitin 2018, kurse pas ristrukturimit të institucionit në vitin akademik 2018 – 2019 ky program studimi u ofrua nga Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë (Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës), dhe në vitin 2019-2020 e në vazhdim nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, deri në diplomimin e studentit të fundit të regjistruar. Gjatë vitit akademik 2019 – 2020 nuk ka pasur të regjistruar në këtë program.</p> <p>Për realizimin e programit mësimor, specifikisht për vitin e II të këtij programi studimi gjatë vitit akademik 2018 – 2019, departamenti përgjegjës angazhoi personel akademik jo vetëm të vetë departamentit por bashkëpunoi edhe me departamente të tjera, si Informatikë dhe Teknologji, Qendra për Zhvillimin e Qëndrueshëm, Qendra për Zhvillimin e Teknologjisë dhe Inovacionit, Ekonomiks dhe Financë, nga të cilët 2 pedagogë me titullin Prof. Dr., 1 me titullin Prof. Asoc. Dr. dhe 4 me titullin Dr.</p> <p>GVJ është i mendimit se institucioni ka ofruar kapacitetet dhe burimet e duhura për ofrimin e këtij programi.</p>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve	Duke ju referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga UET (Raporti Vjetor, Viti akademik 2017 – 2018) UET ka një strategji të kërkimit shkencor për vitet 2017-2020. Për sa kohë programi i studimit “Master i Shkencave” në “Informatikë Ekonomike” me profile, është ofruar nga Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit deri në vitin 2018, mendojmë se fusha e përgjithshme dhe specifike e

kombëtare e evropiane.	<p>programit të studimit ka qenë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore. Shembull janë projektet e shumta të realizuara në fushën e teknologjisë së informacionit.</p> <p>Pas ristrukturimit të njësisë kryesore në vitin akademik 2019 - 2020, kemi një përputhje të pjesëshme të fushës akademike e kërkimore të njësisë kryesore me këtë program studimi duke u fokusuar më shumë tek pjesa ekonomike, që përputhet me natyrën e kombinuar, informatike dhe ekonomike, të profileve të këtij programi studimi (Të dhëna për lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien, Raporti Vjetor Viti akademik 2017 – 2018).</p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Bazuar tek Raporti Vjetor, Viti akademik 2017 – 2018 GVJ ka konstatuar se Ekspertë të motivimit të Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut, përgjegjës për këtë program studimi gjatë vitit akademik 2019– 2020 e në vazhdim, realizuan një kërkim për të kuptuar arsyet pse studentët zgjedhin të studiojnë në Fakultetin Ekonomik dhe TI, gjetjet e të cilit i shërbyen edhe procesit të përshtatjes së planeve të reja mësimore pas ristrukturimit të institucionit në vitin 2018.</p> <p>Gjithashtu duke ju referuar tabelës “Të dhëna për lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien” (Raporti Vjetor, Viti akademik 2017 – 2018) GVJ konstatoi se fusha akademike e kërkimore e Departamentit të Informatikës dhe Teknologjisë (Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës) përgjegjës për këtë program studimi gjatë vitit akademik 2018-2019 përputhet me fushën e përgjithëshme dhe specifike të programit të studimit. Pavarësisht se në vitin akademik 2019-2020 e në vazhdim ky program studimi është nën përgjegjësinë e departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, përsëri Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë si njësi bashkëpunuese meqë programi është ndërdisiplinor, e siguron këtë përputhje.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.5 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe</p>	<p>Duke u bazuar tek dokumentat e vëna në dispozicion (Rregullore e UET; Dokument F.V. Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Departamentit; Analizë Vjetore e Departamentit Informatikë dhe Teknologji mbi Arritjen e Objektivave Formuese të Programit të Studimit “Master i Shkencave” në “Informatikë Ekonomike”) GVJ është i mendimit se UET për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, ka siguruar marrëdhënie të</p>

<p>analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p> <p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>frytshme bashkëpunimi brenda institucionit. Gjithashtu kjo mbështetet edhe nga bashkëpunimi që ka pasur Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit përgjegjës për këtë program studimi, për realizimin e programit mësimor pas ristrukturimit në vitin 2018me Departamentin e Informatikës dhe Teknologjisë, të Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës.</p> <p>Duke ju referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe RVB (Të dhëna për lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien, Raporti Vjetor Viti akademik 2017 – 2018; Ndërkombëtarizimi, etj) GVJ është i mendimit se UET garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Duke u bazuar tek dokumentat e vëna në dispozicion (Ndërkombëtarizimi; Raporti vjetor, Viti Akademik 2017 – 2018; Projekti 205+, etj.) UET ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit si dhe aktorët e biznesit vendës (p.sh. Ludwigshafen Hochschule, University Nova de Lisboa, Portugal, Infosoft Group, Mikrotik, etj).</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion (Projekti 205+; Raport i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit; dhe një sërë Memorandumesh dhe Marrëveshjesh Bashkëpunimi), GVJ evidentoi se institucioni ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione, organizata profesionale dhe biznese të ndryshme. Qëllimi dhe objektivat e këtyre marrëveshjeve kishin në fokus realizimin e objektivave të programve të studimeve për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikave mësimore apo organizimin e trajnimeve profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në bazë të dokumentave për marrëveshjet e bashkëpunimit si dhe mbështetur tek RVB, GVJ evidentoi se institucioni ka nënshkruar marrëveshje me kompani të njohura në fushën e TI por jo vetëm, të tilla si Infosoft; Balfin shpk; AMF; INSTAT; Dhoma e tregtise dhe Industrise; AWARD Group Consultants; E.H.W shpk; QW WEB shpk.</p> <p>Gjithashtu institucioni bashkëpunon edhe me aktorë e institucione të tjera, me të cilat pavarësisht se nuk ka marrëveshje të shkruara, kanë rënë dakord për të pranuar studentët për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikave mësimore apo organizimin e trajnimeve profesionale të mëtejshme. Gjithashtu UET mban kontakte me të gjithë alumnit për t’i krijuar atyre oportunitete punësimi që vijnë nga këto marrëveshje bashkëpunimi.</p>
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	<p>Duke u bazuar tek dokumentat e vëna në dispozicion (Raporti vjetor, Viti Akademik 2017 – 2018; DSSH 2019; Projekti 205+; Ndërkombëtarizimi; Raport i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimi) GVJ mendon se njësia përgjegjëse për programin e studimit “Master i Shkencave” në “Informatikë Ekonomike”, në mënyrë periodike ka hartuar raporte</p>

	analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të këtij programi studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.6
Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	Duke u bazuar tek dokumentat e vënë në dispozicion (Planit Strategjik 2015-2020, Prioritetet në Kërkimin Shkencor; Strategjia e Kërkimit Shkencor 2017-2020; Outgoing Staff Programe) GVJ evidentoi se UET angazhon në kërkimin shkencor burimet njerëzore cilësore me tituj dhe grada që disponon, duke u kujdesur njëkohësisht qënëkëtëproces të përfshijë gradualisht e me standartet e duhura brezin e ri të pedagogëve si dhe studentët e shquar e të interesuar për kërkimin shkencor. UET një pjesë të konsiderueshme të financimeve dhe burimeve njerëzore që disponon i përdor në fushën e kërkimit shkencor. Një pjesë e rëndësishme e shpërblimit të pedagogëve të UET është lidhur direkt me fondin për kërkimin shkencor që vihet në dispozicion në fillim të çdo viti akademik dhe që materializohet në bazë të rezultateve konkrete të matshme e të diferencuara në këtë drejtim.
Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Sipas Strategjisë së Kërkimit Shkencor 2017-2020, UET zhvillon në mënyrë të vazhdueshme mekanizma të menaxhimit të stafit akademik në mbështetje të kërkimit shkencor dhe monitorimit të performancës. Këtij qëllimi i shërben përcaktimi i indikatorëve të Performancës së Kërkimit Shkencor. Sipas RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ evidentoi se UET e vlerëson performancën në kërkimin shkencor në bazë të indikatorëve më bashkëkohorë në këtë drejtim në përputhje me praktikën më të mirë të universiteteve më të shquara në botë dhe zhvilluar, kritereve e treguesve të politikave e standarteve europiane të kërkimit shkencor, etj.
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Mbështetur tek RVB dhe dokumentave të vënë në dispozicion (Strategjia e Kërkimit Shkencor 2017 -2020; Outgoing Staff Programe; DSSH; Planit Strategjik 2015-2020) GVJ është i mendimit se UET ka një politikë të qartë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. Gjithashtu edhe botimi i revistave shkencore nga vetë institucioni është një tregues tjetër i mbështetjes dhe promovimit të kërkimit shkencor. UET ngre strukturë të vecanta ndihmëse dhe orientuese apo krijon funksione specifike shërbimesh në funksion të kërkesave për botimet shkencore-pedagogjike dhe shpërndarjen e tyre në gjithë strukturat e UET.
Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë	Bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion për promovimin dhe

për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	mbështetjen e stafit akademik dhe kërkimit shkencor mund të themi se institucioni i kushton një vëmendje të veçantë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe çështjeve etike.			
Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor.	Në bazë të Planit Strategjik 2015-2020, Prioritetet në Kërkimin Shkencor dhe Prioritetet në marrëdhëniet me studentët dhe jetën studentore, UET angazhon në kërkimin shkencor burimet njerëzore cilësore me tituj dhe grada që disponon duke u kujdesur njëkohësisht qënëkëtëproces tëpërfshijë gradualisht e me standartet e duhura brezin e ri tëpedagogëve si dhe studentët e shquar e tëinteresuar për kërkimin shkencor. Gjithashtu UET synon rritjen e përfshirjes sëstudentëve mëtdalluar tëdepartamenteve apo fakulteteve përkatëse nëkërkimin shkencor, botimet akademike, revistat shkencore, konferencat dhe workshopet, aktivitetin kërkimor-shkencor, etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga institucioni (RVB; Rregullore e UET, Neni 1 Baza Ligjore, Neni 13 Forma e studimit; Kurrikula e Programit; Plani Mësimor,etj) GVJ konstatoi se studimet në programin e studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomikeme dy profile, janë si rregull me kohë të plotë, të organizuara në module ose lëndë dhe të shprehura në kredite (në total 120 kredite), sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS), në frymën e Kartës së Bolonjës.
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneesh e specialitetesh.	Në bazë të dokumentave të tilla si: Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit; Analizë e Departamentit Informatikë dhe Teknologji mbi Arritjen e Objektivave Formuese të Programit të Studimit MSH në Informatikë Ekonomike; Studimi i Tregut; Mbi Parimet e ndërtimit të Programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës, Struktura e Programit
Kriteri 3. Programi i studimit “Master i	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kolcin *Q* 13

<p>shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>të Studimit në dy profile, etj, GVJ është i mendimit se ky program studimi i ka ofruar studentëve një sërë njohurish të veçanta të cilat i kanë dhënë atyre mundësinë të punojnë në një sërë profesione të tilla si Specialist për Analizimin dhe Dizenjimin e Bazave të të Dhënave, Zhvillues Sistemesh TI, Specialisht për SQL Server, etj.</p> <p>GVJ evidentoi se ky program studimi jep njohuri të përparuar ku përfshihet edhe të kuptuarit kritik i teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p> <p>Parimi themelor i ndërtimit të programit të lëndës për këtë program studimi ka qenë 15% lëndë që ofrojnë analizë/ kritikë të teorive dhe aplikimeve të fushës; 70% lëndë që ofrojnë njohuri të thelluara, të aplikuara, krahasuese; 15 % lëndë që ofrojnë njohuri bazë, koncepte.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Sipas Planit Strategjik për Zhvillimin e Programit objektivi kryesor i programit të studimit Msc në Informatikë Ekonomike, me profile është pajisë studentët me njohuri të gjera rreth sistemeve të ndryshme të informacionit që mbështesin proceset e biznesit, ekonomisë dhe mbi aspekte specifike të tyre si siguria, pavarësia nga vendndodhja (p.sh. në aplikime mobile), etj.</p> <p>Për arritjen e objektivit, në program përfshihen lëndë të tilla si Projektim dhe Analizë e Bazave të të Dhënave, Dizenjim dhe Zhvillim i Sistemeve IT, SQL Server dhe Platformat e Raportimit, Aftësi Menaxheriale, Tregu Bankar dhe Institucionet e tij etj. Përveç njohurive bazë në të dyja fushat, studentët kanë pasur mundësi përzgjedhjeje për thellimin e njohurive apo specializimin e tyre nënjërën nga këto dy fusha, informatikë apo ekonomi, në sajë të nëndisiplinave, profileve apo grup-lëndëve me zgjedhje. Duke u mbështetur nga sa më sipër GVJ është i mendimit që ky program studimi ka ofruar njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara.</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Duke u mbështetur tek dokumentacioni i vënë në dispozicion GVJ konstatoi se në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në përputhje me to UET ka hartuar dokumentat e tij, të tillë si “Rregullore e UET” dhe “Rregullore e Programit të Studimit MSH në Informatikë Ekonomike”, të cilat përcaktojnë strukturën e programit të studimit MSH në Informatikë Ekonomike me të gjithë elementët e tij (Pika 3.1 e Rregullores së Programit).</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Duke u mbështetur tek dokumentat e vëna në dispozicion (Rregullore e Programit të Studimit MSH në “Informatikë Ekonomike”, 3.1. Struktura e Programit të Studimit; dhe Kurrikula e Programit) GVJ konstatoi se ky program studimi i ka të përcatuara qartë veprimtaritë formuese të grupuara sipas kategorive dhe me ngarkesën përkatëse në kredite përkatësisht:</p> <p>Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në 5 kategori:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • Kategoria A: Lëndë bazë- 2 lëndë (12 ECTS) • Kategoria B: Lëndë karakterizuese - 10 lëndë (60 ECTS) • Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese - 3 lëndë (18 ECTS) • Kategoria D: Lëndë plotësuese - 1 lëndë praktika profesionale. (12 ECTS) • Kategoria E: Detyrime përmbyllëse - punimi i diplomës (18 ECTS) 								
Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj.	Në bazë të dokumentit “Kurrikula e Programit të Studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike” është i përcaktuar qartë numri i krediteve për realizimin e diplomës (gjithsej 18 kredite). Gjithashtu në bazë të dokumentit “Mbi punimin e diplomës/disertacionit” GVJ konstatoi se UET i ka të përcaktuara me rregullore seancat metodologjike të detyruara për studentët në masën 60%, të cilat zhvillohen nga pedagogët udhëheqës të diplomës në kuadër të zhvillimit të saj dhe aktivitetit kërkimor të studentit. Këto seanca kanë për qëllim të ndihmojnë studentët të përpunojnë aspektin metodologjik të punës së tyre për hartimin dhe paraqitjen e punimit të diplomës. Studenti vlerësohet në përfundim të këtyre seancave dhe ky vlerësim zë 25% të vlerësimit të përgjithshëm të punimit të diplomës.								
Shkalla e përmbylljes së standardit	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përmbyllet</th> <th>Përmbyllet pjesërisht</th> <th>Përmbyllet kryesisht</th> <th>Përmbyllet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht				X
Nuk përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht						
			X						

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbyllet kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbyllet detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Programi i Studimit Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike” me profile “Financë Bankë” dhe “Administrim Biznesi” gjatë vitin akademik 2019 – 2020 e në vazhdim është ofruar nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut si njësi bazë, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit si njësi kryesore, në UET. Duke u mbështetur tek dokumentat: Rregullore E Universitetit Europian të Tiranës; Rregullore Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike”, GVJ është i mendimit se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbyllet detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbyllet detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	UET ka hartuar “Rregulloren e Universitetit Europian të Tiranës” dhe “Statutin e Universitetit Europian të Tiranës” në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Përshtetja e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe me të gjitha vendimet, aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në bazë të këtyre dokumentave (Rregullore e UET, Kreu II; Statuti i UET, Kreu II, Kreu III) GVJ është i

	<p>mendimit se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Në bazë të urdhërit nr. 527 datë 04.09.2018, Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, përgjegjës për këtë program studimi nga viti akademik 2019-2020 e në vazhdim, përbëhet nga 3 njësi bazë, në përputhje me kërkesat ligjore. Këto njësi bazë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës • Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut • Qendra për Zhvillimin e Qëndrueshëm
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Nga ana tjetër njësia përgjegjëse për këtë program studimi, Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut e përmbush kërkesën e ligjit për numrin e PAE dhe raportin me PAK, por që nuk janë të gjithë personelit akademik që japin mësim në këtë program studimi. Përkatësisht numri i PAE është 9 pedagogë nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 Prof. Dr., - 2 Prof. Asoc. Dr., - 4 Dr. - 1 Msc. <p>Numri i PAK është 7 pedagogë nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 Prof. Asoc. Dr., - 2 Dr. - 3 Msc <p>(23.1.Të dhëna tabelare për personelin akademik, 2018 - 2019).</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>UET ka hartuar “Rregulloren e Universitetit Europian të Tiranës” dhe “Statutin e Universitetit Europian të Tiranës” në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015“Përarsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe me të gjitha vendimet, aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në bazë të këtyre dokumentave (Rregullore e UET, Kreu II; Statuti i UET, Kreu II, Kreu III) GVJ është i mendimit se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personelit akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Bazuar tek dokumentat e vëna në dispozicion dhe nga informacioni i marrë nga vizita në institucion GVJ evidentoi se njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi nuk angazhon personelit ndihmës akademik për realizimin e praktikave. Ajo angazhon personelit akademik efektiv për mbikqyrjen e ecurisë së studentëve gjatë periudhës së praktikës dhe mbarëvajtjen e realizimit të saj në institucionet me të cilat UET ka nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit për këtë qëllim.</p>

<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Me anë të Vendim Nr. 96, datë 03.12.2018, të Dekanatit të Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës (si njësia kryesore përgjegjëse për këtë program studimi pas ristrukturimit) është caktuar koordinatori i këtij programi studimi, njëri nga pedagogët më me përvojë të këtij programi dhe që mban titulli Prof. Dr.Ai është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale. Detyrat kryesore të koordinatorit përcaktohen në aneksin bashkëlidhur vendimit të emërimit, si edhe në aktet rregullatore të UET.</p>			
<p>Kriteri 7. Koordinatorit të programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësive përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të paraqitur GVJ konstatoi se detyrat e koordinatorit të programit janë të përcaktuara qartë në dokumentin “Aneks-Detyrat e koordinatorit të programit të studimit” ku evidentohet që ai raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësive përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.3

Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ evidentoi se njësia kryesore dhe njësia bazë që janë përgjegjëse për këtë program studimi disponojnë të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit. Këto informacioni gjenden të qarta në dokumentat e mëposhtëme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullore e UET; • Rregullore Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike”; • Kurrikula e Programit Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike”; • Plani Mësimor i Programit Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike”.
<p>Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p> <p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe</p>	<p>Në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi institucioni ka hartuar dokumentin “Rregullore e UET, Neni 16” në të cilën përcaktohen rregullat e organizimit të të gjitha programeve të studimit.</p> <p>Në përputhje me këtë rregullore, dokumenti “Rregullore Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike”: 3.1. Struktura e Programit të studimit” përcaktohen qartë lëndët, modulet, praktika dhe aktivitetet formuese të këtij programi studimi.</p> <p>Ndarja specifike është e pasqyruar tek Kurrikula e Programit Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike” nga të</p>

<p>mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>cilat kemi:</p> <p>Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në 5 kategori:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kategoria A: Lëndë bazë- 2 lëndë (12 ECTS) • Kategoria B: Lëndë karakterizuese - 10 lëndë (60 ECTS) • Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese-3 lëndë (18 ECTS) • Kategoria D: Lëndë plotësuese - 1 lëndë praktika prof. (12 ECTS) • Kategoria E: Detyrime përmbyllëse-punimi i diplomës (18 ECTS) <p>GVJ konstatoi se Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra. Kreditet e një disipline fitohen vetëm pas vlerësimit të studentit me notë kaluese, kjo e përcaktuar në Statutin e UET, neni 29.</p> <p>Në bazë të dokumentit Plani Mësimor i Programit Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike” GVJ konstatoi se në të gjendet në gjitha informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Informacione të tjera të nevojshme në lidhje me këtë program studimi, të tilla si, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, etj., janë të paraqitura qartësisht në “Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike” pika 5 dhe 6, si dhe në “Rregulloren e UET, Kreu 5”.</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ bazuar te shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion evidentoi se programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Këto informacione janë të shprehura qartë në dokumentat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullore e UET; • Statuti i UET Neni 37; • Rregullore Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike”. <p>Përsa i përket kriterëve të përgjithshme dhe specifike të pranimit të studentëve në këtë program studimi GVJ është i mendimit se nuk ka kriteret të përcaktuara qartë për pranimin e studentëve të diplomuar jashtë fushës së studimit të këtij programi, meqënëse nuk përjashtohet mundësia e pranimit të këtyre studentëve që kanë një diplomë Bachelor të ndryshme nga fusha e Informatikës Ekonomike apo të ngjashme me të.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, si dhe bazuar tek dokumentat e paraqitura në “Dorëzimi i Dosjes së Vetëvlerësimit në IAL” GVJ konstatoi se Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat,</p>

formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	seminaret apo orët e laboratorit. Gjithashtu të të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara gjenden qartësisht të shprehura në dokumentin “Plani Mësimor i Programit Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike”.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur GVJ evidentoi se përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale. Kjo gjë është e përcaktuar në Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike” Pika 10. Sipas RVB ndryshimet propozohen nga Departamenti, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave, por edhe nga anëtarë të personelit akademik, në konsultim me Bordet e Tregut të Punës, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme. Propozimi për ndryshime në çdo rast vjen i argumentuar nga personi i interesuar. Rishikimi i programit mund të parashikojë bashkime lëndësh ose ndarje të tyre, por pa cenuar raportet e përcaktuara për secilën kategori disiplinash në program, rishikimin e krediteve, të lëndëve, të teksteve që do të përdoren por edhe të literaturës. Meqë ky program studimi është i licensuar në gjuhën shqipe ndryshimet ruhen në gjuhën shqipe.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	GVJ evidentoi se ngarkesa e programit të studimit Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike” me dy profile është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Në bazë të Rregullores Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike”, pika 3 dhe 4 përcaktohet ngarkesa në orë mësimore në auditor, si dhe puna individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Studenti që ndjek këtë program studimi duhet të marrë së paku 120 ECTS.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të	GVJ është i mendimit që kurrikula e programit të studimit në përgjithësi është një kurrikul që i përgjigjet qëllimit dhe objektivave të programit të studimit.

<p>mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ është i mendimit se disa lëndë p.sh Algoritmikë Programim i Avancuar (Java 1), Zhvillim Web-i, Aplikim dhe Programim dhe Menaxhimi i Rrjetave Kompjuterike kanë pjesë të cilat mund të përshtaten më shumë me nivelin Bachelor. Gjithashtu lënda Aplikim i Sistemeve të Informacionit mund të kishte një emër tjetër më të përshtatshëm me përmbajtjen.</p> <p>Në përgjithësi GVJ është i mendimit që emërtimi, përmbajtja e veprimtarive (në një pjesë të lëndëve), shpërndarja e lëndëve dhe praktikave i mundësojnë studentëve të këtij programi studimi rritjen e aftësive dhe punësimin e tyre. Sugjerojmë se ka nevojë për përmirësimin e përmbajtjes së disa lëndëve në mënyrë që programi i studimit ti mundësojë studentëve thellimin e njohurive dhe vazhdimin e studimeve të mëtejshme.</p> <p>Kjo gjë mbështetet edhe në dokumentat: Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës; Rregullore Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike”; “Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave, E.VIII.3.5.Veprimtaria kërkimore-shkencore.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Duke u bazuar tek dokumentat e vëna në dispozicion (Rregullore Mësimore e Programit të studimit Msc në “Informatikë Ekonomike”; Plani mësimor i programit të studimit Master Shkencor në “Informatikë Ekonomike”; Kurrikula e programit të studimit Msc në “Informatikë Ekonomike”) GVJ konstatoi se ky program studimi është ofruar në 2 vite mësimore, gjithsej 4 semestra me kohëzgjatje normale 15 javë/në një semestër, dhe në përfundim të tij studentët kanë marrë 120 kredite (ECTS). Shpërndarja e lëndëve në semestra dhe shpërndarja e krediteve sipas lëndëve bën të mundur arritjen e objektivave formues të këtij programi studim dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor (Rregullore Mësimore e Programit të studimit, Pika 3.3).</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Duke u bazuar tek dokumentat e vëna në dispozicion (Plani mësimor i programit të studimit Master Shkencor në “Informatikë Ekonomike”; Kurrikula e programit të studimit Master Shkencor në “Informatikë Ekonomike”; Rregullore Mësimore e Programit të studimit Master Shkencor në “Informatikë Ekonomike”; “Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës”) si dhe bisedat në institucion me personat përgjegjës GVJ konstatoi që struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Gjithashtu sipas dokumentit “Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave, E.VIII.3.4.Ndërkombëtarizimi” zhvillimi i kurrikulave të programit i referohet praktikave më të suksesshme ndërkombëtare, me qëllim rritjen e përputhshmërisë së tyre me kurrikulat në universitetet perëndimore, për të lehtësuar transferimin e studimeve dhe njohjen e krediteve, dhe</p>

	<p>për të rritur mundësitë e bashkëpunimit me universitetet partnere për programe të përbashkëta studimi, ose dhënien e diplomave të dyfishta. Kjo mbështetet edhe nga dokumenti “Plani strategjik për zhvillimin e programit” sipas të cilit me Sistemin Europian të Transferimit të Krediteve që programi ofron mundësohet transferimi i studimeve në universitetin e një shteti tjetër, në Europë ose më tej, si dhe njohja e diplomës. Një mundësi për këtë është edhe programi POSIG.</p>
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Sipas Rregullores Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike” Pika 10 syllabuset e lëndëve përditësohen çdo vit akademik. Propozimi për ndryshime bëhet nga pedagogët e lëndës, njësia përgjegjëse për zhvillimin e programit, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave, sugjerimet që mund të vijnë nga konsultimet me Bordet e Tregut të Punës, etj.</p> <p>Gjithashtu sipas Rregullores së UET dhe bisedave me NJBSC, GVJ konstatoi se literatura e detyruar dhe ndihmëse i përket 5 viteve të fundit. Kjo u vërtetua edhe në vizitën në Bibliotekë.</p>
<p>Kriteri 7. Përbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Programi i studimit në objektivat e tij synon thellimin dhe zgjerimin e njohurive sikurse aftësimin e studentëve për kërkim të pavarur shkencor. Qëllimi është përgatitja e studentëve për zhvillimin e karrierës së tyre: në drejtim akademik ose praktik (duke u përfshirë në tregun e punës).</p>
<p>Kriteri 8. Përbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Jo të gjitha lëndët e përfshira në kurrikulën e programit të studimit ju garantojnë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme mbi procesin e kërkimit shkencor dhe i pajisin me dije të integruara midis disa fushave si: menaxhim, financë, menaxhim projektsh IT, dizejnim dhe zhvillim software-ësh, rrjeta kompjuterike, baza të dhënash, etj. Në këtë kontekst, vlerësojmë që përbajtja e programit të studimit nuk është plotësisht e përshtatshme për t’i lejuar studentët të vazhdojnë studime të mëtejshme.</p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>GVJ konstatoi në bazë të vizitës së bërë në institucion dhe dokumentacionit (“Rregullores Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike” Pika 10.2”; “Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave, Pika E.VIII.3.1.”) programi i studimit, plani mësimor, lëndët dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program, si dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike. Ndryshimet propozohen nga Departamenti, Zyra e Kurrikulave, por edhe nga anëtarë të personelit akademik, në konsultim me Bordet e Tregut të Punës, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme.</p>
<p>Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit përfshin njohjen e studentëve me metodat e avancuara të kërkimit shkencor nëpërmjet lëndës “Metoda kërkimi të avancuara”. Gjithashtu GVJ konstaton që dokumenti “Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës” përcakton që 15% të programit e zënë njohuritë bazë dhe konceptet e lëndës në përputhje me objektivat e ciklit të parë; 70% të</p>

	programit e zënë njohuritë e thelluara, të aplikuara dhe krahasuese në lëndë, në përputhje me informacionin që duhet të jepet në ciklin e dytë; 15% të programit e zënë analiza e thelluar dhe kritika e teorisë dhe aplikimeve të fushës, në përputhje me informacionin e ciklit të tretë. Megjithatë GVJ është i mendimit që përmbajtja e disa lëndëve mundëson pjesërisht njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	<p>Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesëshme i angazhuar në këtë program studimi i përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Politikat dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të përcaktuara qartë në rregulloren e institucionit Pika G.I. dhe janë në përputhje me Ligjin Nr. 8015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe Kodin e Punës, të ndryshuar.</p> <p>Për realizimin e programit mësimor, specifikisht për vitin e II të këtij programi studimi gjatë vitit akademik 2018 – 2019, departamenti përgjegjës angazhoi personel akademik jo vetëm të vetë departamentit por bashkëpunoi edhe me departamente të tjera, si Informatikë dhe Teknologji, Qendra për Zhvillimin e Qëndrueshëm, Qendra për Zhvillimin e Teknologjisë dhe Inovacionit, Ekonomiks dhe Financë, nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 pedagogë me titullin Prof. Dr., - 1 me titullin Prof. Asoc. Dr. dhe - 4 me titullin Dr. <p>Pra numri total i personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi është 7, nga të cilët 5 janë Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe 2 janë Personel Akademik me Kontratë (PAK).</p> <p>Rezulton stafi PAE është mbi 71 % ndaj atij PAK. Të gjithë kanë kualifikimin e nevojshëm dhe gradat shkencore sipas kërkesave të ligjit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me disa kontrata pune të pedagogëve efektivë dhe me kontratë.</p>
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të	Në pjesën më të madhë të tij personeli akademik efektiv dhe me

plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	kontratë ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik që kërkon ligji si në drejtimin e programit të studimit edhe në zhvillimin e lëndëve përkatëse. Në ato raste ku kualifikimi akademik i pedagogëve nuk është ai i duhuri, institucioni ka përcaktuar me anë të rregullores së brendshme përfshirjen e ekspertëve të fushës së teknologjisë së informacionit që kanë çertifikime ndërkombëtare në këtë fushë.			
Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Njësia përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit. GVJ konstatoi se pas ristrukturimit të njësisë kryesore në vitin 2019, kemi një përputhje të pjesëshme të fushës akademike e kërkimore të njësisë kryesore me këtë program studim duke u fokusuar më shumë tek pjesa ekonomike, që përputhet me natyrën e kombinuar, informatike dhe ekonomike, të profileve të këtij programi studimi (Të dhëna për lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien.			
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion (Mbi punimin e diplomës/disertacionit) si dhe gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se institucioni ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucioni të rëndësishme në vend nëpërmjet të cilave realizohen praktikat profesionale të studentëve. Gjithashtu nëpërmjet rregullores (Pika B.II. 4) përcaktohen kriteret që duhet të plotësojë personeli akademik për udhëheqjen e diplomave të studentëve të këtij programi studimi. Pedagogët duhet të kenë të paktën gradën shkencore Doktor dhe nuk mund të udhëheqin më shumë se 10 studentë në vit.			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Në bazë të Statutit të UET, Neni 45 si dhe nga informacioni që morëm në institucion, GVJ konstatoi se UET siguron angazhimin e personelit ndihmës në ndihmë të personelin akademik për realizimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e laboratorëve. Përkatësisht në ndihmë të këtij programi studimi është zyra e IT e cila ka katër punonjës, dy prej të cilëve janë në mbështetje të procesit mësimor dhe dy merren me çështjet teknike që lidhen me laboratorët dhe mjediset e tjera mësimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu	Duke u mbështetur tek dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe bisedat gjatë vizitës në institucion me personat përgjegjës GVJ konstatoi se përmbajtja e programit të studimit përditësohet çdo vit akademik (Rregullores Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë, Master

i punës.	i Shkencave në “Informatikë Ekonomike” Pika 10). Me propozim nga pedagogët e lëndës, njësia përgjegjëse për zhvillimin e programit, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave, dhe sugjerimet që mund të vijnë nga konsultimet me Bordet e Tregut të Punës, ku çdo departament ka bordin e tij i cili përbëhet nga ish studentë të UET sipas programeve përkatëse të studimit dhe përfaqësues të suksesshëm të fushave të ndryshme të biznesit.			
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	Gjatë takimit me studentët dhe pedagogët e këtij programi studimi GVJ u informua se institucioni përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Kjo gjë realizohetjo vetëm nga diskutimet që studentët mund të bëjnë me personelit akademik, por edhe zyrtarisht një herë në muaj përfaqësuesi i këshillit të studentëve merr pjesë në mbledhjet e departamentit ku diskutohen problematika të ndryshme dhe dërgohet zëri i studentëve dhe sugjerimet apo kërkesat e tyre (bazuar edhe tek dokumenti “Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit, pika F. V.)			
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	Gjithashtu institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit. Një nga mënyrat është përfshirja e tyre në Bordin e Tregut të Punës nga i cili vijnë propozime konkrete për përmirësimin e vazhdueshëm të programit. Sipas dokumentit “Plani strategjik për zhvillimin e programit” janë më shumë se 10,000 ish-studentë të diplomuar, të punësuar sot në kompani private, institucione publike, organizata jo-fitimprurëse ose që kanë marrë iniciativën e vetëpunësimit. Nëpërmjet “UET ALUMNI” UET mban dhe zhvillon lidhjet me të diplomuarit. “UET ALUMNI” dhe stafi i UET takohen periodikisht, të gatshëm të ndihmojnë dhe mbështesin njëri-tjetrin.			
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi.</p>	Si rezultat i konsultimeve që UET ka bërë me Bordet e Tregut të Punës, institucionet e ndryshme publike dhe private me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, të tilla si INSTAT, AMF, Mikrotik, Infosoft Group, Reiffeissen, etj, ka vendosur të riorganizojë programin e studimit Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike”. Këto ndryshime së bashku me shpjegimet përkatëse pasqyrohen në dokumentin “Rrëshikimi i kurrikulës”.			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesore</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion (Rregullore Mësimore e Ciklit të Dytë të Studimit Master i Shkencave në “Informatikë</p>

<p>të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Ekonomike”, me dy profile, pika 3.3) GVJ evidentoi se objektivat specifike të programit janë shprehur qartë, midis të cilave mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Thellim, zgjerim dhe specializim të koncepteve; • Parapërgatitje për licencën e profesionit të rregulluar; • Aftësi për kërkim të avancuar, të pavarur shkencor; • Aftësim i plotë për zhvillim karriere, si dhe për vazhdimin e studimeve të doktoratës, etj. <p>Këto objektiva janë në përputhje me objektivat strategjike dhe vizionin e UET që synon të jetë një universitet lider për zhvillimin e dijes, qendër ekselence në formimin akademik, qendër ekspertize e specializuar në fushat përkatëse të studimit, qendër ekselence për kërkimin shkencor, etj.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se departamenti përgjegjës për këtë program studimi mbështet personelin akademik në proceset e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor duke respektuar liritë akademike të tyre. Kjo evidentohet në procesin periodik të përmirësimit të syllabuseve të lëndëve të cilat vijnë kryesisht nga propozimet pedagogëve përkatës. Nga bisedat e zhvilluara në institucion GVJ u informua që personeli akademik mbështetet në përfshirjen e tij në programin kërkimor “Shqipëria Inovative” apo në grupe kërkimore ku përfshihen edhe studentët e doktoraturës apo studentët të programit Master Shkencor.</p> <p>Në bashkëpunim me Qendrën e Metodologjisë dhe Kërkimit, ofrohen trajnime 1-ditore ose me gjatë për të rritur aftësitë e stafit akademik për tëndërmarrëpunë kërkimore të pavarur që të jetë e botueshmenë revista shkencore me faktor impakti. Trajnimet janë të ndarë në katër grupe: (1) Trajnime për Doktorantë; (2) Trajnime për Junior Researchers; (3) Trajnime për Senior Researchers; (4) Trajnime Metodologjike.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Institucioni ka inkurajuar dhe motivuar studentët për tu përfshirë në projekte dhe aktivitete kërkimore nëpërmjet “Shkollës Dimërore për Inovacionin”, Konferencës “Ditët e Studimeve Shqiptare”, etj. Gjithashtu sipas RVB dhe bisedave të bëra gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi që pjesëmarrja në kërkimin shkencor vlen vetëm për studentët ekselentë dhe duhet të konfirmohet nga titullari i drejtimit shkencor, të vlerësohet prej tij me pikë (maksimumi 20) përkundrejt një produkti kërkimor në formën e një raporti me shkrim, i cili i dorëzohet pedagogut të lëndës.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Në bazë të Raportit Vjetor, Viti Akademik 2017 – 2018, GVJ evidentoi se departamenti përgjegjës për këtë program studimi mbështet politikat studimore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe kjo provohet më së miri nga bashkëpunimet ndërinstitucionale dhe projektet (Tabela Pjesëmarrje në projekte UET 2013 – 2017). Gjithashtu kjo mbështetet edhe nga aktivitete vjetore të tilla si “Startups Europe Comes to University” që zhvillohet çdo Tetor si pjesë e një rrjeti Europian të 35 universiteteve dhe 17 shteteve, apo “Dita e Sipërmarrjes” në kuadër të muajit të sipërmarrjes kudo në</p>

	botë që zhvillohet çdo Nëntor.			
Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Në bazë të dokumentit “Strategjia e Kërkimit Shkencor në UET 2017-2020” aktiviteti kërkimor i UET financohet nga një sistem i dyfishtë: burimet e brendshme dhe donacionet/financimet nga jashtë. UET vendos në dispozicion të stafit akademik një fond kërkimor 75000 Euro tek i cili kërkuesit mund të aplikojnë për mbështetje për ndërmarrjen e projekteve kërkimore ose për shpërbllim pas publikimit në revista dhe libra të botuara nga shtëpi botuese me reputacion ndërkombëtar. Nga bisedat gjatë vizitës në institucion GVJ u informua që ky financim do të jetë në vlerën 2500 Euro për botimet në revista me faktor impakti mbi 1.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.8				
Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Bazuar tek dokumenti “Strategjia e kërkimit shkencor 2017-2020” GVJ konstatoi se UET e mbështet kërkimin shkencor në tre shtylla kryesore: Kërkimi dhe Botimet; Trajnimi dhe Çertifikimi dhe Research and Development. Si pjesë e këtij sistemi janë Projektet e Mëdha Kërkimore (në grupe kërkimore ose individuale) zhvillimi i të cilave ka sjellë përfitime të drejtpërdrejta në realizimin e objektivave të programit të studimit Master i Shkencave në “Informatikë Ekonomike”, me dy profile. Gjithashtu Zyra e Projekteve dhe Partneriteteve është në ndihmë e madhe për grupet apo individët që duan të marrin pjesë në projekte kërkimore shkencore.			
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Bazuar tek dokumenti “Lista e botimeve shkencore dhe projekteve të stafit akademik me kohë të plotë (Viti Akademik 2018-2019)” GVJ konstatoi se ka një angazhim të madh të personelit akademik përgjegjës për këtë program studimi në bashkëpunim me studentët, në projekte kërkimore shkencore, konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe botime në revista shkencore.			
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Në ndihmë të personelit dhe studentëve, për arritjen e objektivave në lidhje me kërkimin shkencor, UET organizon konferencën e përvitshme “Ditët e Studimeve Shqiptare”, ku çdo fakultet ka panelin e vet, në të cilin zhvillohen aktivitete të dedikuara fushave të studimit të departamenteve përkatëse.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.	Institucioni nëpërmjet Rregullores së UET Neni 17 përcakton qartë mënyrën e planifikimit të procesit mësimor dhe metodave të mësimdhënies sipas të cilit procesi mësimor zhvillohet me leksione, seminare, punë laboratorike, detyra praktike, detyra kursi, provime të ndërmjetme, provime përfundimtare, praktika profesionale, punim diplome, Provim të Përgjithshëm Përfundimtar, projekte etj.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Në bazë të dokumentave të vënë në dispozicion (Rregullore e UET Neni 22) GVJ konstatoi se vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies së personelit akademik kryhet përmes: <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi të Dekanit, Përgjegjësit të Departamentit dhe/ose përgjegjësit të grup-lëndës përkatës;
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimi të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi të studentëve që kryhet në fund të çdo semestri duke ruajtur anonimin e tyre, si dhe fokus grupeve me studentët dhe përmes opinioneve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit;
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	<ul style="list-style-type: none"> • Vetëvlerësimi; • Rezultateve të raporteve të KSBC-së; • Vlerësimi nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës që ngrihet nga Rektori (follow-up). • Leksioneve të hapura, për një nga temate planifikuara. <p>Rezultatet e përpunuara u bëhen me dije personelit akademik të interesuar dhe autoriteteve drejtuese.</p> <p>Në bazë të kësaj rregulloreje si dhe nga bisedat me studentët gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se studentët janë të përfshirë në vlerësimin periodik të mësimdhënies. Gjithashtu rregullorja e përcakton qartë në Nenin 22 bërjen publike të rezultateve të vlerësimit. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me disa nga dokumentat që përfshin ky proces të</p>

	cilat ndodheshin në dosjet personale të pedagogëve.			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Një nga objektivat e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë është monitorimi i vazhdueshëm i nivelit të cilësisë së mësimdhënies të stafit akademik dhe ndihmës, përmes vlerësimit nga studentët (pyetësorë, focus grupe, etj.), si edhe kualifikimit të tij, përmes të dhënave nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Gjithashtu UET kryen në vazhdimësi trajnimin e personelit akademik dhe promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Bazuar tek dokumentacioni (Rregullore e UET Neni 17; Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës Pika A.III.3) dhe takimet me studentët dhe pedagogët në institucion GVJ konstatohet se format e mësimdhënies për këtë program studimi janë ato të miratuara nga institucioni, duke përfshirë: <ul style="list-style-type: none"> - Leksionet: 37.5 kredite/420 orë mësimore në auditor - Seminarët /punë laboratorike: 36 kredite/174 orë mësimore në auditor - Projekte/detyra kursi: 22.5 kredite/270 orë mësimore në auditor - Praktike, Internship: 12 kredite/255 orë mësimore në auditor - Diplome/provim përfundimtar: 18 kredite/ 36 orë mësimore në auditor Gjithsej: 120 kredite/1155 orë mësimore në auditor
Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	Gjatë vizitës në institucion në takimet me pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi GVJ u informua se personeli akademik është i gatshëm të përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve duke ofruar forma e metoda alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. Kjo evidentohet në përshtatjen e orarit të mësimin në orët e mbasdites apo të fundjavës, meqënëse një pjesë e studentëve në këtë program studimi janë të punësuar. Gjithashtu ka pasur raste të përshtatjes së metodave të mësimdhënies dhe testimit të njohurive për persona me aftësi ndryshe. Gjithashtu në bazë të Rregullores së UET Neni 18 mësimi mund të zhvillohet edhe individual në përputhje me specifikat e lëndëve apo të studentëve.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të	Për mbështetur personelin e tij akademik në përmirësimin e tij të vazhdueshëm në procesin e mësimdhënies institucioni zhvillon trajnime për

<p>të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>zhvillimin e kompetencave didaktike të tyre. Në bazë të dokumentit “Burimet Njerëzore Pika G.I.12.Certifikimi i Personelit” UET kryen në vazhdimësi trajnimin e personelit akademik. Në bazë të rolit që anëtari i personelit do të kryejë në institucion, atij do i duhet të marrë një ose disa prej certifikimeve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Certifikata e mësimdhënies dhe e këshillimit akademik; • Certifikata e kërkimit shkencor; • Certifikata e drejtimit të grupit kërkimor, etj.
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Duke u mbështetur tek dokumentacioni i vënë në dispozicion (CV e pedagogëve) por edhe tek bisedat me studentët, drejtuesit, etj, GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve si dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Kjo gjë mbështetet edhe nga rëndësia që institucioni i jep kriterëve që aplikon në rekrutimin e personelit akademik (dokumenti mbi Politikën dhe Procedurat e Rekrutimit të Personelit Akademik Pika G.I.2 Kriteret) ku disa nga kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi/rekrutimi i kandidaturave, janë treguesit e performancës së kandidatëve, të tillë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përvoja në mësimdhënie në nivel universitar, si dhe karriera profesionale jashtë auditorit; • Cilësia dhe standardet e universitetit ku është diplomuar kandidati, duke i dhënë përparësi universiteteve perëndimore; • Aftësitë komunikuese dhe etika; • Paraqitja gjatë leksionit të hapur para Departamentit përkatës, etj. <p>Gjithashtu institucioni përdor vlerësimin periodik të procesit mësimor me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies (Rregullore e UET Neni 22). Në procesin e vlerësimit janë të përfshirë jo vetëm drejtuesit e institucionit dhe të departamentit por edhe studentët. Vlerësimi i studentëve kryhet në fund të çdo semestri, gjithashtu vlerësimi kryhet nëpërmjet fokus grupeve me studentët dhe përmes opinionëve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit merren masa për të reflektuar ndryshimet e nevojshme dhe të miratuara nga drejtuesit dhe pedagogët.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Gjatë bisedave që patëm në institucion me personelin akademik, me studentët dhe drejtuesit e departamentit dhe institucionit GVJ konstatoi se personeli akademik përdor metoda të ndryshme interaktive për ta bërë orën e mësimi sa më tërheqëse duke përfshirë edhe studentët në këtë proces.</p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë</p>	<p>Në këtë mënyrë mësimi zhvillohet jo vetëm mbi bazën e shpjegimit të koncepteve thelbësore të lëndës por edhe diskutimeve midis grupeve të studentëve, zhvillimit të praktikave apo simulimit në laborator të programeve të ndryshme kompjuterike. Gjithashtu interaktiviteti dhe</p>

mes tyre	iniciativa e pavarur e studentëve shihet tek zhvillimi i detyrave të kursit dhe tek krijimi i grupeve online të bashkëpunimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion (Infrastruktura në Funkcion të Programit të Studimit) por edhe gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se UET ka hapësira të mjaftueshme dhe cilësore në funksion të procesit mësimor të këtij programi studimi.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.	Përveç 33 salla mësimore, (leksione dhe seminare) të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit në rang institucional, kemi dhe salla të dedikuara për këtë program studimi të pajisura me logjistikën e nevojshme, siç janë 4 Laboratorë Informatike, përkatësisht: <ul style="list-style-type: none"> • Lab 205 B me 25 PC dhe video projektor rreth 45 m²; • Lab 206 B me 35 PC dhe video projektor rreth 45 m²; • Lab 207 B me 35 PC dhe video projektor rreth 45 m²; • Lab 208 B me 80 PC (laboratori i internetit) rreth 160m².
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Për studentët që zhvillojnë programe të avancuara të informatikës, janë instaluar programet Navicat for my SQL, NetBeans, Apache Tom Cat. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor. Në dispozicion të lëndëve të lidhura me inovacionin, është vënë Laboratori “Inovation Hub”, i cili ndodhet në sallën 208, në katin e dytë të godinës A. Ky laborator ka një kapacitet prej 24 PC. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së TI. Instalimet e programeve dhe azhurnimet e tyre bëhen në kohë reale. Në të njëjtën kohë programet kompjuterike iu janë përshtatur programeve mësimore duke instaluar programet aplikative që kërkohen nga departamentipërgjegjës për këtë program studimi. Gjithashtu UET ka investuar në sisteme të cilat e mbështesin studentin në procesin mësimor. Më konkretisht në sistemin MOODLE (UET LMS), ky sistem bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive, etj. Studenti ka mundësi të komunikojë nëpërmjet sistemit në forume të

	hapura me pedagogët si dhe kolegët e kursit që ndjek apo të shikojë notat dhe pikët on-line nga kudo që ndodhet.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.	Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me mjediset e bibliotekës dhe literaturën bazë dhe ndihmëse të programit të studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike, me dy profile. Literatura është e bollshme dhe bashkëkohore, kryesisht në gjuhën angleze dhe e pesë viteve të fundit.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Një vend të veçantë në fondin e Bibliotekës së UET-it zënë titujt e shumtë akademikë (kryesisht tekste bazë dhe monografi) të botuara nga UET-Press, të cilat kanë autorë shqiptarë ose janë përkthime të disa prej botimeve më të mira dhe më të fundit të Universitetit të Oksfordit të botuara në shqip nga UET Press. Hapësirat e bibliotekës janë komode në një shtrirje prej 300 m ² , dhe oraret janë në përshtatje me nevojat e studentëve gjatë gjithë ditës deri në orët e vona të mbrëmjes.
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	GVJ u informua gjatë vizitës në institucion, por mbështetur edhe tek RVB dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion, se biblioteka e UET furnizohet vazhdimisht me botime periodike në shqip dhe në gjuhë të huaj. Institucioni mbështet gjetjen e burimeve on-line të kërkuara nga pedagogët dhe studentët. Gjithashtu UET ka bërë abonime në biblioteka virtuale të cilat ofrojnë për studentët dhe stafin akademik mijëra tituj librash dhe artikuj shkencorë bashkëkohorë të tilla si Sage, Ebsco (abonim 5-vjeçar), Questia si dhe revista shkencore në hard copy të tilla si Harvard Business Review, The Economist, etj.
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	GVJ u informua gjatë takimit me studentët dhe pedagogët e programit të studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike se mësimi zhvillohet kryesisht në 3 laboratorët (205 B, 206 B, 207 B) që janë vënë në dispozicion të këtij programi studimi. Gjithashtu edhe salla e madhe Lab 208 B është gjithmonë në dispozicion të studentëve dhe zhfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme prej tyre, kryesisht për kërkime në internet në funksion të detyrave të kursit, projekteve, etj.
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion GVJ u informua se që në vitin 2017 në kuadër të dixhitalizimit të procesit të mësimdhënies dhe menaxhimit më efektiv të tij UET ka realizuar vendosjen e UET LMS dhe UMIS (sistemi i menaxhimit online të mësimdhënies) me të gjitha funksionet e tij. Personeli akademik, sekretaria dhe studentët i përdorin gjerësisht këto sisteme duke realizuar një komunikim në koherencë dhe të suksesshëm mes palëve. Institucioni kryen çdo vit trajnime të personelit dhe studentëve për përdorimin e këtyre platformave në mënyrë që të ketë ecuri pozitive të shfrytëzimit të tyre.
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Gjithashtu GVJ u informua se personeli akademik ka akses nëpërmjet intranetit të institucionit mbi Sistemin e Brendshëm Elektronik të Dokumentave të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe jo

	vetëm. Kjo sjellë edhe plotësimin e rekomandimit të KA.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre	Sipas Rregullores Mësimore të këtij programi studimi, Pika 8 është e përcaktuar qartë që zgjedhja e temës së diplomës për studentët bëhet me ndihmën e pedagogut udhëheqës. Zgjedhja e temës dhe puna për shkrimin e punimit të diplomës nis që në fillim të vitit të parë akademik. Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat metodologjike, sipas një kalendari takimesh, të shpallur.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies institucioni përfshin bashkëveprimin e disa prej strukturave të tij të cilat janë përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Këto struktura janë: <ul style="list-style-type: none"> • Strukturat hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet) të UET-it; • Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, e cila kujdeset për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e cilësisë dhe praktikata e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe për monitorimin e zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit. • Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë – KSBCi cili nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit të veprimtarive që ushtrohen në UET ka synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.
Kriteri 2. Njësi kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.	Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit është përgjegjës për këtë program studimi dhe cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në të (në këtë vit akademik). Departamenti është përgjegjës për cilësinë e rekrutimit të personelit akademik, për cilësinë e sylabuseve të lëndëve, zhvillimin e procesit mësimor, zhvillimin e provimeve, etj. Departamenti zhvillon çdo javë mbledhje në të cilat diskutohen dhe ju jepet zgjidhje problematikave të ndryshme që lidhen me cilësinë e programin e studimit që ofron. Në këto mbledhje çdo muaj marrin pjesë edhe përfaqësues të studentëve të cilët çojnë kërkesat dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e procesit mësimor.
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	GVJ gjatë bisedave me personelin akademik dhe studentët u informua se

	departamenti përgjegjës për këtë program studimi është suportues në zhvillimin e metodave të reja dhe inovative të mësimdhënies.
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Në bazë të Statutit të UET Neni 36 Pika 2 institucioni garanton integrimin e veprimtarisë kërkimore shkencore me atë të mësimdhënies, me qëllim rritjen e cilësisë në mësimdhënie. Gjithashtu sipas Strategjisë së Kërkimit Shkencor në UET 2017 – 2020, institucioni e ka si objektivi strategjik të realizojë një mjedis stimulues të kërkimit shkencor për stafin akademik dhe studentët nëpërmjet:
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	<ul style="list-style-type: none"> • Standardizimit dhe ndërkombëtarizimit të kërkimit shkencor; • Strukturimit të një sistemi koherent të kërkimit shkencor dhe certifikimit të stafit akademik; • Trajnimit dhe certifikimit të aftësive të stafit akademik për të prodhuar dhe botuar dije origjinale shkencore; • Institucionalizimit të mëtejshëm të Projekteve të Mëdha Kërkimore (PMK) dhe grupeve kërkimore për rritjen e ndër-disiplinaritetit, maksimizimin e burimeve njerëzore, dhe shërbimin ndaj palëve të treta të interesuara në produktin shkencor të UET. <p>Gjzatë bisedave me personelin akademik GVJ u informua që pedagogët mbështeten nga institucioni në procesin e kërkimit shkencor edhe nëpërmjet financimit të pjesmarrjes në konferenca apo botimit të artikujve në revista të rëndësishme shkencore.</p> <p>Gjithashtu institucioni në kuadër të përmirësimit të aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja kryen trajnime të vazhdueshme në lidhje me mësimdhënien, këshillimin në karrierë dhe kërkimin shkencor për personelin akademik por jo vetëm, të tilla si: “Si të jemi lektorë të suksesshëm”, “Si të publikojmë dhe hulumtojmë”, “Rregullat bazë të komunikimit dhe marketingut”, “Çfarë është edukimi”, “Çfarë do të thotë të menaxhosh”, “Zhvillimi i personelit akademik”, etj.</p>
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Gjzatë bisedave me personelin akademik dhe drejtuesin e departamentit përgjegjës për këtë program studimi GVJ u informua se ata janë përgjegjës dhe të angazhuar plotësisht në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe testimin e metodave të reja alternative në funksion të përthithjes sa më mirë të njohurive nga studentët. Kjo gjë u pohua edhe në takimin me studentët të cilët informuan GVJ që stafi akademik përdorte metoda të ndryshme të mësimdhënies dhe përçimit të materialeve didaktive tek ata. Kjo gjë bëhet kryesisht nëpërmjet sistemit LMS me anë të të cilit jo vetëm komunikohet me studentët për elementët e procesit mësimor por edhe gjenerohen raporte për aktivizimin e studentëve, për rezultatet, etj. Në fund të çdo viti akademik analizohen raportet e gjeneruara nga LMS dhe shikohen efektet e aplikimit të sistemit.
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	
Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor,	Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor si dhe plotësimin të nevojave të departamenteve UET angazhon

<p>angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>personel akademik jo vetëm efektiv por edhe me kontratë në kuadër të bashkëpunimeve që ka me institucionet homologe dhe bizneset e rëndësishme jo vetëm në vend por edhe të huaj.</p> <p>Duke u bazuar tek dokumenti mbi “Politikat dhe Procedurat e Rekrutimit të Personelit Akademik”, GVJ konstatoi se përveç pedagogëve me tituj e grada, për nevoja të veçanta dhe për periudha të caktuara, në UET mund të punësohen edhe pedagogë që nuk kanë tituj e grada, por që kanë një përvojë të gjatë e të suksesshme në profesionin dhe institucionin e tyre, janë unikë në fushën e tyre të specializimit, etj. Marrja e tyre bëhet për të plotësuar kërkesa të veçanta të programit mësimor, të tilla si lëndë me karakter praktik, cikle specifike leksionesh dhe seminaresh, orësh praktike, etj. Gjithashtu në procesin mësimor mund të angazhohen edhe lektorë të huaj nga universitetet partnere ose nga universitete të tjera analoge. Lektorët e huaj mund të angazhohen në një semestër të plotë normal gjatë vitit mësimor, në semestrin e verës, ose në cikle të veçanta leksionesh e seminaresh brenda programit mësimor të një lënde të caktuar.</p> <p>Në bisedat që zhvilluam me studentët GVJ u informua që ka pasur raste të leksioneve të hapura që janë realizuar nga lektorë të njohur dhe me përvojë në fushat e tyre të kërkimit shkencor.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1.Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Sipas Rregullores Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike Pika 5.2, GVJ konstatoi se mënyra e kontrollit dhe e vlerësimit të dijës mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementeve të mëposhtme:</p>
<p>Kriteri 2.Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Provimit të ndërmjetëm (30%) • Nivelit të diskutimit (10%) • Detyrës së kursit (esse, prezantime, projekte)/dy detyra praktike (20%) • Teza/Provimit përfundimtar (40%) <p>Pika 2.6e kësaj rregulloreje përcakton se në fillim të vitit akademik organizohet java orientuese, ku mbahen takime dhe leksione për shpjegimin e sistemit të studimeve, të rregulloreve dhe të procedurave administrative në UET, si dhe kurse parapërgatitore ekstra-kurrikulare.</p> <p>Studentët informohen në sistemet e platformave si UMIS, LMS apo me anë të postës elektronike në lidhje me format e vlerësimit dhe detyrimeve që duhet të</p>

	përbushin lidhur me to.			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Sipas Rregullores së UET Neni 24 përcaktohet mënyra e testimit dhe vlerësimi të njohurive dhe dijeve të marra gjatë procesit mësimor. Ajo realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Mënyrat e vlerësimi varen sipas Tipologjisë së lëndës (Tipologjia I ose II). Gjithashtu Në rastin e studentëve me aftësi ndryshe, titullari i lëndës zgjedh formën më të përshtatshme të provimit, sipas përcaktimeve në dokumentin përkatës (Rregullore e UET Neni 27).			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Sipas Rregullores Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike Pika 5.2 përcaktohet mënyra e kontrollit dhe e vlerësimi të dijeve. Vlerësimi bëhet nëpërmjet 4 aktivitetëve kryesore (Diskutime në seminare; Detyrë kursi; Provim i ndërmjetëm; Provim përfundimtar) gjatë gjithë semestrit që zhvillohet çdo lëndë dhe vlerësimi përfundimtar është shumë e të gjithë këtyre rezultateve.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimi, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit (Rregullore Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike Pika 5.3) si dhe gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me procedurat e zhvillimit të provimeve në këtë program studimi. Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. Sekretimi i tezave përmes sistemit të barkodeve ofron sekretim të identitetit të studentit dhe paanshmëri të vlerësimi. Gjithashtu aplikimi i projektit Clean Score, i cili realizon korrigjimin e automatizuar të provimeve mundëson rritjen e besueshmërisë dhe transparencës në këtë proces.
Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimi të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh jo vetëm me procedurën e zhvillimit të provimeve por edhe me procesin paraprak të hartimit të tezave dhe ngritjen e komisioneve prej dy anëtarësh për realizimin e tyre, njëri anëtar ishte titullari i lëndës. Këtë gjë GVJ e evidentoi edhe ngashqyrtimii disa fletëve të provimeve që i zgjodhi në mënyrë të rastësishme nga arkiva e departamentit.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimi i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	Sipas Rregullores Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike Pika 5.3.2 provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. Gjithashtu GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se në sallat ku zhvillohen provimet gjendet e gjithë infrastruktura e nevojëshme për zhvillimin

	korret të tyre, përfshirë edhe kamerat e sigurisë.			
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	GVJ u informua gjatë takimit me studentët dhe pedagogët e këtij programi studimi, se gjithmonë vlerësimi i provimeve shoqërohet me komente për të ndihmuar studentin të kuptojë sa ka arritur të përvetësojë nga lënda dhe çfarë duhet të përmirësojë. Kjo gjë u evidentua konkretisht edhe gjatë shqyrtimit të disa fletëve të provimeve që GVJ i zgjodhi në mënyrë të rastësishme nga arkiva e departamentit.			
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në bazë të Rregullores së UET Neni 33 njësia përgjegjëse dhe personeli akademik nuk e tolerojnë plagjiaturën dhe kopjimin nëpër provime dhe detyra të tjera. Ata përpiqen të informojnë paraprakisht studentët edhe për rrjedhojat dhe saksionet e parashikuara nëse ky nen mund të shkelet.			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Sipas Rregullores Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike Pika 5.3.4 rezultati i vlerësimit bazohet gjithmonë mbi meritën e studentit dhe jepet në kohën e përcaktuar nga kjo rregullore. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 javëve nga data e zhvillimit të tyre, brenda të cilave përfshihen edhe seancat sqaruese, ku pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin. Pas këtij afati, pedagogu plotëson dhe dorëzon procesverbalin përfundimtar në Sekretarinë Mësimore.			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Sipas Rregullores Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike Pika 5.8 në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit, pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës ai mund t'i drejtojë Drejtuesit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën.			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Përgjegjësi i Departamentit ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vlerësimi që bën komisioni, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar. Kjo procedurë është transparente dhe dokumentohet në arkivën e departamentit.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Sipas dokumentit “Rregullore Mësimore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike” përcaktohen qartë tek objektivat e programit thellimi i njohurive dhe zhvillimit i aftësive profesionale të

<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>veçanta të teknologjisë së informacionit. GVJ konstaton që kjo realizohet më së miri nga një pjesë e konsiderueshme e lëndëve që ofrohen në këtë program studimi.</p> <p>Gjithashtu në këtë program studimi literatura e përdorur është bashkëkohore dhe e 5 viteve të fundit kryesisht në gjuhën e huaj duke i dhënë mundësi studentëve të marrin njohuritë më të avancuara të momentit.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Duke u bazuar tek dokumenti “Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës” pedagogu i lëndës i prezanton studentët që në fillim të semestrit me programin, objektivat, kompetencat dhe aftësitë që pritet të fitojë studentit gjatë zhvillimit të lëndës. Në fund të semestrit gjithashtu këto elementë shqyrtohen dhe analizohen përsëri për të vënë në dukje arritjet e studentëve dhe pikat ku ata duhet të punojnë më shumë.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Gjatë bisedave që patëm në institucion me pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi GVJ u informua se në përfundim të çdo lënde pedagogu i orienton studentët për provimin, çështjet më të rëndësishme ku duhet të bazohen, i ofron konsultime sipas nevojave dhe kërkesave të tyre në mënyrë që ata të jenë sa më të qartë për përmbajtjen dhe zhvillimin e provimit përfundimtar.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit në institucion GVJ u informua nga drejtuesit, pedagogët dhe studentët se në funksion të këtij programi studimi por jo vetëm, institucioni ofron periodikisht leksione të hapura për çështje të rëndësishme të teknologjisë dhe biznesit. Kryesisht këto leksione realizohen nga pedagogët më me eksperiencë dhe kualifikimin më të lartë shkencor, por gjithashtu edhe nga ekspertë të njohur të fushës nga institucionet partnerë brenda dhe jashtë vendit, si dhe bizneset më të suksesshme me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Duke u bazuar tek dokumenti “Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës, A.III.3.Format e zhvillimit të procesit mësimor dhe A.III.4.2.2.Metoda pedagogjike” si dhe bisedat me studentët dhe pedagogët GVJ konstatoi se mësimdhënia dhe mësimnxënia realizohet mbi bazë kompetencash në mënyrë që t’u japë studentëve mundësinë të zhvillojnë njohuritë e marra në laborator dhe praktikat profesionale. Gjithashtu pedagogët motivojnë studentët të zhvillojnë sa më shumë diskutime dhe të punojnë në grup gjatë procesit mësimor. Në këtë mënyrë klima që krijohet ndihmon studentët në zhvillimin e ideve inovative dhe i çon ata drejt studimeve më të avancuara.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>UET ka qenë mbështetës i ideve inovative dhe i motivon dhe promovon ato tek studentët duke ofruar edhe mbështetjen financiare. Sipas RVB dhe dokumentave të vëna në dispozicion GVJ konstaton aktivitete të tilla si Shkolla Dimërore e Inovacionit apo thirrjet për pjesëmarrje në konkurse</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	
<p>Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	

	për propozim idesh, të organizuara nga UET.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	<p>UET ka një nga prioritetet e veta strategjike bashkëpunimin me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit me qëllim rritjen e mobilitetit të studentëve. Konkretisht në këtë program studimi ka pasur shumë studentë që kanë përfituar bursat Erasmus të mobilitetit, por ka pasur edhe studentë të huaj që nëpërmjet tyre kanë ardhur të ndjekin disa lëndë në këtë program studimi.</p> <p>Një rol të rëndësishëm në këtë proces ka pasur Zyra e Projekteve e cila realizon gjithë procesin që nga shpërndarja e thirrjeve për këto bursa deri tek intervistimi dhe shpallja e studentëve përfitues të tyre.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Institucioni i ka përcaktuar qartësisht procedurat për provimin final ose mbrojtjen e diplomës në Rregulloren e UET, Neni 39. Gjithashtu procedura e diplomimit të studentëve të këtij programi studimi ju bëhet e qartë me anë të dokumentit “Rregullore Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike, Pika 8”; si dhe “Mbi punimin e diplomës/disertacionit”.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Studentët njihen me këto dokumenta që në fillim të vitit të vitit të parë akademik. Brenda javës së pestë të semestrit të parë të vitit akademik, studentët pajisen nga Departamenti përkatës me formularin e aplikimit për temën e diplomës. Të drejtën për të aplikuar për punim diplome e kanë studentët me notë mesatare në hyrje së paku 7.5 përndryshe mbrojtja bëhet përmes dhënies së një provimi të përgjithshëm përfundimtar.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua që nëse studentët e mbrojnë diplomën nëpërmjet një provimi të përgjithshëm përfundimtar ky provim do të bazohet mbi lëndët më të rëndësishme që karakterizojnë programin e studimit dhe profilin përkatës. Kjo gjë vendoset nga komisioni i posaçëm që krijohet nga pedagogët e lëndëve, koordinatori i programit dhe përgjegjësi i departamentit. Bazuar edhe tek RVB konstatohet që studentët marrin leksionet e hedhura në sistemet elektronike të miratuara (LMS apo UMIS), u jepet një grup pyetjesh orientuese për secilën kategori lëndësh dhe zhvillohen seanca sqaruese një ditë përmbledhëse ku çdo pedagog informon një nga një mbi lëndën që mbulon çështjet ku studentët duhet të fokusohen më së shumti.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin	Sipas dokumentit “Mbi punimin e diplomës/disertacionit” brenda javës së

e temave të tezës/diplomave.	pestë të semestrit të parë të vitit akademik, studentët pajisen nga Departamenti me formularin e aplikimit për temën e diplomës shoqëruar me listën e pedagogëve të mundshëm udhëheqës dhe me inventarin e temave të propozuara. Studenti plotëson formularin e aplikimit në konsultim paraprak me një pedagog dhe e dorëzon atë brenda afatit të shpallur. Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat metodologjike, sipas një kalendari takimesh, të shpallur të cilat janë orë në auditor, konsiderohen formalisht si orë seminaresh, që kanë për qëllim të ndihmojnë studentët të përpunojnë aspektin metodologjik të punës së tyre për hartimin dhe paraqitjen e punimit të diplomës (B.II.5). Gjatë këtyre seancave udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Pedagogu drejtues i seancave metodologjike pranon, vlerëson dhe paraqet në Sekretarinë Mësimore dosjen e strukturave të punimeve të studentëve që marrin pjesë në këto seanca (B.II.5.4.). Sipas Rregullores Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike, Pika 8 studentin nuk mund të mbrojtë temën e diplomës pa marrë miratimin e udhëheqësit si garantues i cilësisë së saj akademike.
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentin vlerësohet me notë.	Në përfundim të provimit ose të mbrojtjes së diplomës studentin vlerësohet me notë (ku 25% të këtij vlerësimi e përbën vlerësimi që studentin merr në përfundim të seancave metodologjike nga pedagogu udhëheqës). Nëse nota është kaluese ai përfiton 18 kredite ECTS, përndryshe nëse studentin merr notë jokaluese në sezonin e parë të mbrojtjes së diplomës ka të drejtë të paraqitet për mbrojtje në sezonin e ardhshëm. Studentin ka të drejtë të hyjë 2 herë në mbrojtje të diplomës. Në rast se edhe pas herës së dytë rezultoni mbetës, studentin duhet të ndryshojë temën dhe të paraqesë një punim të ri diplome (Sipas Rregullores Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike, Pika 8).
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studentin pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Sipas Rregullores së UET Neni 40 dhe 41, studentin që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor, ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj UET-it dhe ka përmbushur detyrimet përmbyllëse të programit të studimit, pajiset nga institucioni brenda 6 muajsh me diplomën përkatëse, të shoqëruar me certifikatën e notave të marra gjatë studimeve universitare në UET, me suplementin e diplomës, të firmosur nga Dekani dhe Sekretari i Përgjithshëm. Sipas dokumentit "Mbi punimin e diplomës/disertacionit, Pika B.II.15.2." sekretaria Mësimore harton dhe e pajis studentin me Suplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht).
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentin i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Gjithashtu sipas RVB dhe informacionit që morëm në institucion GVJ u informua që në përfundim të studimeve, studentin ka të drejtë të kërkojë të marrë një kopje zyrtare të syllabuseve të programit të studimit të zhvilluar.
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe	Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua nga drejtuesit e këtij programi studimi se institucioni ruan në zyrën e kontratave për një periudhë 2 vjeçare

paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	kopje të dokumentacionit të studentit, dhe pastaj për një periudhë të pacaktuar i ruan në arkivë dhe i paraqet sipas rastit informacionet për studentin nëse kërkohen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1				
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.	Gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore, grupi i vlerësimit të jashtëm konstatoi që zyra disponon dokumentacion të plotë për çdo anëtar të personelit të angazhuar në këtë program studimor, që përfshin diplomat, certifikat e ndryshme, vërtetimet për gradat akademike, CV-të, kontratat, vlerësimi akademik etj. Të dhënat janë të përditësuara atëherë kur kjo është e nevojshme si p.sh. Kontratat, CV-të etj.			
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Institucioni disponon me procedura të defnuara për sa i përket rekrutimit të stafit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Këto procedura së bashku me kriteret specifike sipas kërkesës për pozicione të caktuara bëhen publike në momentin që shpallet një pozicion vakant.			
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.				
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	Institucioni në përgjithësi ndjek procedurat për rekrutim dhe vlerësim mbështetur edhe në kriteret e vendosura për punësim në master shkencor nga baza ligjore në fuqi. Gjithsesi evidentohet një rast i angazhimit të pedagogut të jashtëm që nuk ka shkallën shkencore të duhur për mësimdhënie në Master i Shkencave, gjatë vitit akademik 2017-2018.			
Shkalla e përmbushjes së	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

Standardi IV.2
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Nga vizita e GVJ u konstatua se institucioni ofron kushte të përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit si p.sh. zyra komode, laboratore për zhvillim të mësimdhënies dhe projekteve të tyre, pajisje teknike etj. Institucioni nxit kualifikimin e vazhdueshëm të personelit duke ofruar grante për zhvillim dhe publikim të rezultateve nga kërkimet e tyre shkencore, si dhe duke vendosur procedura të pikësimit për arritjet e tyre.								
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Përveç kësaj realizohen trajnime rreth metodave të reja të mësimdhënies për stafin ekzistues, që kryesisht si bartës kryesor kanë Departamentin e Edukimit. Për stafin e ri ofrohet trajnim përkatës për fillim në jetën akademike, ku ndër të tjerat përfshihet edhe ndjekja e leksioneve të pedagogëve me përvojë në lëndët ku ata janë të angazhuar si asistentë. Politikë e institucionit është që të pedagogët të kenë katër lëndë në vit, mund të kenë lëndë të pestë nëse është lëndë metodologjike.								
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.									
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë	Institucioni ka problemin të cilin e kanë shumica e institucioneve të arsimit të lartë kur bëhet fjalë për programet që kanë të bëjnë me shkencat kompjuterike dhe aplikimet e tyre, që ka të bëjë me mungesën e njerëzve të kualifikuar me gradën shkencore të duhur për mësimdhënie në këto fusha. Nga menaxhmenti i institucionit u shprehën se arsyeja kryesore për këtë situatë qëndron në mos-hapjen e programeve të reja të doktoraturës.								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Standardi IV.3
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kwrkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Institucioni zhvillon gjithë aktivitetin e tij më kampusin kryesor të përbërë nga dy godina kryesore, duke siguruar kështu mjediset e mjaftueshme për zhvillimin e mësimdhënies për këtë program studimi. Orët praktike realizohen në laboratorët e informatikës. Brenda kampusit gjendet edhe biblioteka që ofron hapësirë të bollshme

	për studentët që duan të mësojnë aty.			
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Gjatë vizitës GVJ konstatoi se mësimi i programit studimor zhvillohet në 4 salla mësimdhënies si vijon: <ul style="list-style-type: none"> • Lab 205 B me 25 PC dhe video projektor rreth 45 m² • Lab 206 B me 35 PC dhe video projektor rreth 45 m² • Lab 207 B me 35 PC dhe video projektor rreth 45 m² • Lab 208 B me 80 PC (laboratori i internetit) – 160m² 			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Të gjitha sallat në të cilat zhvillohet mësimdhënia janë të pajisura me kompjutera dhe projektorë, të cilat ofrojnë mundësi të kuptimit më të mirë të lëndëve dhe realizimit më praktik të tyre. I gjithë ambienti universitar është i mbuluar me sinjal Wi-Fi me qëllim qasjen në internet në çdo kohë nga ana e studentëve dhe personelit.			
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Institucioni siguron disa labore të teknologjisë së informacionit, me parametra të nevojshëm për sigurim cilësor të mësimdhënies. Një nga laboratorët disponon edhe me tabelë interactive, ndërsa një tjetër më pajisje harduerike që përdoren për mësimdhënie dhe demonstrim në lëndët që kanë të bëjnë me harduerin.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Institucioni ka akomoduar një pjesë të praktikave pranë kompanive të ndryshme si p.sh. Infosoft dhe Albtelecom. Pjesa tjetër pastaj akomodohen pranë zyrave të ndryshme të institucionit si biblioteka, zyra e IT, zyra e karrierës, zyra e aktiviteteve etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Pjesë e axhendës së GVJ ishte edhe vizita në bibliotekën e institucionit, e vënë në dispozicion të studentëve për mësim dhe literaturë. Biblioteka zotëron gjithsej 6005 tituj të disponueshëm për studentët, nga këto në shqip janë 4634 tituj dhe në gjuhë të huaj 1371. Biblioteka ishte e pajisur me libra fizikë (hard copy) për shumicën e lëndëve të programit studimor, kryesisht në gjuhën angleze. Përveç kësaj ofrohen edhe libra elektronikë për të gjitha lëndët e
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme	

për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	programit studimor, kjo edhe për shkak të zhvillimit shumë dinamik të fushës dhe nevojës për literaturë sa më të përditësuar.			
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Përveç librave fizikë dhe ambientit, biblioteka ofron edhe akses online pa pagesë për studentët, kryesisht për punime shkencore si biblioteka EBSCO etj.			
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka është e pajisur me kompjutera dhe programe kompjuterikë që u mundëson studentëve qajse pa kufizime në bibliotekën online.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Institucioni ka si politikë pasurimin e vazhdueshëm të bibliotekës me titujt të ri në mbështetje të programeve të studimit.			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon nga 9:00 deri në 20:00 (gjatë ditëve të javës) dhe ditën e shtunë 9:00:17:00. Gjatë sezoneve ofrohen orare më të zgjatura për mësim nga studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Institucioni ka ndërtuar sistemin për menaxhimin e studentëve, ku studentët regjistrohen që në momentin kur pajisen me ID dhe email institucional. Ky sistem regjistron të dhënat që kanë të bëjnë me studentët gjatë gjithë ciklit të tyre në institucion që përfshin vendosjen dhe leximin e notave, orareve, aktiviteteve të ndryshme deri në momentin e diplomimit.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi lejon edhe akses për pedagogët dhe personelin administrativ, ku ata mund të vendosin dhe marrin informacion. U informuam se notat finale nuk vendoseshin online nga pedagogët, por dërgoheshin offline (me procesverbal) në sekretari dhe sekretaria pastaj i vendos në sistem.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Informacioni që aksesohet është i dedikuar për çdo përdorues, p.sh. notat mund të shihen vetëm individualisht (notat personale, jo dhe notat e të tjerëve).
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv	Zyra IT është mjaft e angazhuar në integrimin e moduleve të ndryshme nga sistemi për menaxhimin e mësimdhënies me sistemin për

dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	menaxhimin e studentëve, me qëllim informimin në kohë reale të studentëve me ecurinë e tyre në procesin mësimor.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Përveç moduleve për integrim, janë vendosur edhe module për raportime të ndryshme si p.sh. raportime nga vlerësimet online të studentëve. Me këtë sigurohet edhe monitorimi dhe raportimi i punës së personelit akademik për drejtuesit dhe menaxhmentin e institucionit.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Informacionet që lidhen me aktivitetet e ndryshme janë të publikuara në faqen e internetit, por vetëm në gjuhën shqipe. GVJ nuk arriti të gjejë asnjë informacion të publikuar që ka të bëjë me programin e studimit. Kjo ndoshta edhe sepse programi është i mbyllur dhe nuk ofrohet për regjistrime të reja.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga raporti i vlerësimit të brendshëm rezulton se institucioni harton raport financiar të kostove dhe planin për mbështetje financiare të programit të studimit. Plani përmban një raport të drejtë të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe këto raporte gjinden në Zyrën e Finances.
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	Buxheti financiar hartohet në fillim të çdo viti akademik dhe miratohet nga aksioneri i institucionit. Të ardhurat e institucionit janë ato të siguruara nga tarifat e studimit që paguajnë studentët. Përgjegjësinë për menaxhimin financiar e ka Administratori dhe Zyra e Financës. Plani i buxhetimit të programit të studimit përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja etj.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Institucioni i nënshtrohet auditimit çdo vit nga ekspertë financiarë. Raportet financiare përmbajnë një pasqyrë të qartë të situatës financiare për përdorimin e të ardhurave të grumbulluara nga shërbimet që ofron institucioni në funksion të realizimit të programit të studimit

Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe planifikon financimin e programit të studimit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Institucioni dëshmon se ka qëndrueshmëri financiare gjatë zhvillimit të programit të studimit. Kjo evidentohet edhe nga numri i bursave të ekselencës që ofrohen për studentë me mesatare të lartë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Nga dokumentacioni që na është vënë në dispozicion konstatohet se institucioni ka hartuar gjithë procedurat e nevojshme që mbulojnë ciklin e studimit nga regjistrimi deri në diplomim, ku përfshihen rregullorja akademike, rregullorja e njësish bartëse të programit studimor, rregullore të programit studimor.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Të gjitha këto garantojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët që duan të regjistrohen në program, si edhe atyre tashmë të regjistruar në programin studimor.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve janë të vendosura në rregulloren e programit studimor, si për studentët që regjistrohen për herë të parë, ashtu edhe për ata që transferohen nga ndonjë institucion tjetër. Nuk është qartë e vendosur cili profil i diplomës është i nevojshëm për regjistrim në këtë program studimor. Gjatë vizitës na u tha që bëhet analizë rast pas rasti për të parë nëse një kandidat është i përshtatshëm për të vazhduar me këtë program studimi.
Kriteri 4. Institucioni harton dhe	Institucioni përpara fillimit të viti akademik harton kriteret për pranim të

publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	studentëve në ciklin e dytë të studimeve. Këto kritere dhe procedura përdoren për udhëzim të kandidatëve, të cilët kanë interes për t'u regjistruar në programet studimore të ciklit të dytë.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2				
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Sipas RVB institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve. Poashtu informon edhe në lidhje me njohjen e kualifikimeve të mëparshme gjatë transferimit nga ndonjë program tjetër studimi, në ndonjë tjetër institucion të arsimit të lartë konform Kartës së Bolonjës.			
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.				
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Studentët informohen në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve në fillim të çdo semestri për çdo lëndë veçmas duke u vënë në dispozicion sylabuset e lëndëve dhe duke u dhënë sqarim shtesë nga ana e pedagogëve përkatës.			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Studentët informohen në lidhje me kriteret e procedurat e e punimit të diplomës dhe diplomimit duke u vënë në dispozicion rregulloren e programit të studimit dhe duke u dhënë sqarim shtesë nga ana e pedagogëve përkatës.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Të interesuarit informohen në mënyrë periodike nëpërmjet udhëzuesve të ndryshëm, ditëve të hapura dhe uebit në lidhje me programet e studimit për të cilin ata janë të interesuar. Gjatë vizitës GVJ u informua për qëndrimin 3 ditor të 40 maturantëve në institucion si pjesë e një projekti, ku nga këta maturantë u përzgjedhën disa studentë të ardhshëm për bursa të ekselences.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3					
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.					
Kriteret		Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.		Që në fillim të studimeve studentët janë të informuar për kohëzgjatjen e studimeve konform bazës ligjore në fuqi. Gjithashtu informohen për strukturën e programit studimor, shoqëruar me informacionin rreth përmbajtjes së lëndëve/moduleve.			
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.		Gjithë ky informacion u vihet në dispozicion edhe online, nëpërmjet platformës për menaxhim të mësimdhënies Moodle që në javën e parë të vitit akademik. GVJ konstaton se ka patur një ndryshim lëndësh ndryshe nga ajo që është dhënë në fillim.			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.		GVJ konstaton një kooperim i mirë midis institucionit dhe botës së biznesit. Për të patur përjasje më të lehtë në tregun e punës, si dhe për të patur feedback për kompetencat e studentëve pas diplomimit krahasuar me nevojat e tregut, janë formuar edhe Bordet e punës që kanë 11 anëtarë, ku shumica janë alumni i institucionit. Me ndihmën e bordeve të punës dhe kontratave të lidhura me kompani nga bota e biznesit janë realizuar mjaft internshipe me banka/kompani partnere. Gjatë vizitës GVJ u informua për internshipet e fundit 3-mujore në Intesa, ku kishin edhe tutor për ndjekjen e intershipit. Studentët janë vazhdimisht të informuar rreth mundësive të ndryshme për internshipe. Studentët vazhdojnë të disponojnë me emailin institucional edhe si alumni dhe në këtë mënyrë arrijnë të informohen për mundësi punësimi edhe pas diplomimit.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.		Kur fillojnë me studimet, studentët informohen mbi organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet ndaj studentit. Studentëve që në fillim u alokohet një email institucional, regjistrohen në sistemin për menaxhimin e mesimdhënies Moodle dhe sistemin për menaxhimin e studentit. Me ndihmën e këtyre tre kanaleve ata informohen për elementet e reja dhe përditësimet në procesin e përgjithshëm gjatë ciklit të tyre të studimit.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.					
Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve		Sistemi për menaxhimin e studentit mundëson menaxhimin dhe raportimin në kohë reale të aktivitetit mësimor të studentëve, si dhe menaxhon dhe monitoron informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për ndjekjen e procesit mësimor.			
Shkalla e përmbushjes së		Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Studentët kanë qeverinë e tyre, nëpërmjet së cilës ata janë të përfaqësuar në organet vendimmarrës të institucionit sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p> <p>Institucioni garanton përfaqësimin e studentëve në vlerësimin e përgjithshëm të procesit akademik kryesisht nëpërmjet të fokus grupeve dhe sondazheve të cilat bëhen në fund të çdo semestri akademik. Sondazhet bëhen online dhe si të tilla janë lehtësisht të verifikueshme dhe të matshme.</p>			
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Gjatë hartimit të programit studimor merren në konsideratë gjithë rekomandimet për ngarkesën akademike të studentëve në auditor dhe mësim jashtë auditorit sipas parashikimeve ligjore e nënligjore në fuqi. Për këtë arsye është vendosur edhe një template si për programet studimore, ashtu edhe për organizimin e moduleve ku janë të vendosura qartë ngarkesat përkatëse në orë sipas krediteve.</p> <p>E njëjta vlen edhe për njohjen e krediteve nga studime të mëparshme - bëhen llogaritë për transferime dhe lejohet kalimi nga një vit në tjetrin konform parashikimeve ligjore në fuqi.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Studentët japin feedback-un e tyre në lidhje më programin e studimit, organizimin dhe përmbatjen e tij.</p> <p>Përveç kësaj ata japin komentet dhe sugjerimet e tyre në lidhje ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimin nga ana e personave përgjegjës.</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Komentet dhe sugjerimet e studentëve pastaj merren në konsideratë gjatë rishikimit të programeve mësimore dhe përmbatjes së moduleve, si dhe angazhimit të personelit akademik në vitet pasuese.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore

dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	Nga CV-të e dorëzuara të pedagogëve dhe kërkimit në baza elektronike të punimeve shkencore, vihet re që personeli akademik është i angazhuar në konferenca ndërkombëtare dhe aktivitete tjera në fushën e kërkimit shkencor.			
Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.	Institucioni ka mjaft marrëveshje të lidhura me 40 institucione të huaja të arsimit të lartë, kryesisht brenda kornizave të programit Erasmus+. Në bazë të këtyre marrëveshjeve janë realizuar mjaft projekte të përbashkëta në fushën e kërkimit shkencor.			
Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.	Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentët, nuk u evidentua pjesëmarrja e studentëve në shkrimin dhe publikimin e punimeve shkencore në këtë program studimor.			
Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	Institucioni mbështet financiarisht publikimin në revista dhe konferenca shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore. Për këtë qëllim është alokuar fond i posaçëm prej 75.000 Euro për stafin që boton artikuj në revista shkencore të indeksuara në Thomson Reuters, në mënyrë që personeli akademik dhe studentët të nxiten dhe suportohen në aktivitetin e tyre shkencor.			
Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	Megjithëse institucioni është mjaft suportues ndaj kërkimit shkencor në përgjithësi dhe studentëve në veçanti, nuk evidentohen raste të studimeve inovative dhe patentave.			
Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	Gjatë vizitës, grupit për vlerësim të jashtëm iu vendosën në dispozicion disa diploma të rastit, që dëshmonin suport dhe asistencë të personelit akademik në punën e përgjithshme kërkimore të nevojshme për realizimin e diplomës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.7	
Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	Institucioni ndjek dhe realizon me sukses një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, duke mundur mobilitetin e studentëve dhe personelit. GVJ u informuar se deri tani rreth 200 studentë kanë bërë një exchange semester në ndonjë universitet evropian dhe 37 studentë kanë ardhur për studime një semestrale në këtë institucion.
Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	Institucioni ndjek praktika të mobilitetit për studentët. Në takimin me studentët u njoftuam edhe më një rast konkret mobiliteti të një studenti, i cili na informoi në mënyrë më të detajuar për eksperiencën dhe vlerën e

	fituar në semestrin jashtë.			
Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	Programi i studimit në vija të përgjithshme ofron mundësi për vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve. Gjithsesi, nga analiza e syllabusesve vihet re se disa lëndë kanë një përmbajtje që nuk është në nivel të kënaqshëm për një program studimi në master shkencor, që paraqet parakusht për ndjekjen e mësimit në ciklin e tretë të studimeve.			
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.	Nga CV-të e dorëzuara të personelit akademik dhe bisedave me personelin akademik konstatohet që ka angazhim të studiuesve të rinj në projekte kërkimore të institucionit.			
Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.	Në vizitën e realizuar u informuam se në institucion janë zhvilluar leksione nga pedagogë të huaj në lidhje me kërkimin shkencor.			
Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	Gjatë diskutimeve me personelin dhe menaxhmentin u informuam se institucioni praktikon angazhimin e pedagogëve të huaj, të cilët përveçse janë të përfshirë në projekte kërkimore, angazhohen edhe në mësimdhënie. Gjithashtu në momentin e vizitës, 6 studentë nga Spanja ndiqnin mësimin në këtë institucion si pjesë e një programi për mobilitet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.8

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	GVJ gjatë vizitës ju komunikua se institucioni ka ndërtuar procedura dhe një system në shërbim të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. Kjo me qëllim ndjekjen dhe asistimin sa më të mirë të studentëve në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor gjatë ciklit të tyre të studimit.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Nga vizita në institucion konstatuam se studentëve u ofrohet shërbim i vazhdueshëm për çështje që kanë të bëjnë me karrierën e tyre dhe tregun e punës. Përveç njësisë së posaçme për këshillim të karrierës, pranë çdo departamenti ka poashtu një këshillues karriere. Organizohen edhe panire të punës, ku prezantohen 50 subjekte për çdo fakultet në një javë të përcaktuar paraprakisht. Gjatë kësaj jave mbledhen bordet përkatëse të punës, ftohen ekspertë të fushës, caktohen tema kryesore rreth të cilave do të diskutohet (sfida e HR në teknologji) etj.

Kriteri 4. Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, ndihmuar edhe nga bordi i karrierës që përbëhet kryesisht nga studentë të diplomuar në këtë institucion. Alumni poashtu vazhdon të jetë i informuar rreth mundësive të ndryshme që ofron institucioni.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në strukturën e institucionit ekzistojnë procedura dhe politika për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë sipas parashikimeve ligjore e përcaktimeve nënligjore në fuqi për këto programe studimi. Brenda strukturave të institucionit ushtron veprimtarinë njësia e posaçme që ndjek strategjinë për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëmtë akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Sistemi për sigurimin e cilësisë përdor instrumenta të ndryshëm që ndjekin një politikë të qartë për sigurimin e cilësisë e që përfshijnë dy aspekte kryesore: monitorimin e procesit të mësimdhënies/mësimnxënies dhe analizën e programeve studimore (kurrikulave) së bashku me përmbajtjen e programeve të lëndëve (sylabuset). Situata e akreditimit institucional dhe të këtij programi është: - Akreditimi i programit: Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 54, datë 06.02.2013, me afat 6 vjeçar. - Akreditimi Institucional është me Vendim të Bordit të Akreditimit nr 46, datë 05.07.2019 (Riakreditim) me afat deri në 2022
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të	Duke u mbështetur tek raporti i RVB, diskutimeve në institucion si

qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjse përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit	dhe dokumentin FVII “Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë”, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar një politikë të qartë për sigurimin e cilësisë, duke krijuar kështu një kulturë të cilësisë në rang institucional, që përfshin parimet mbi të cilat ndërtohet siguri i brendshëm i cilësisë duke definuar qartë objektivat, standardet dhe strukturat përgjegjëse për këtë qëllim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe sqarimet që u dhanë në institucion, rezultojnë se janë ngritur njësi për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.			
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	Mekanizmat dhe proceset e formalizuara iu vendosën në dispozicion GVJ, së bashku me sqarimet përkatëse për çdo proces në veçanti. Nga të gjitha këto GVJ konstatoi se ekziston një proces i vazhdueshëm i mbikëqyrjes së programit studimor.			
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	Si instrumente kryesore për vlerësimin e mbarëvajtjes së programit të studimit përdoren: 1) sondazhet online të studentëve, që realizohen në Moodle dhe pastaj integrohen në sistemin për menaxhim të cilësisë;			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	2) diskutimet me studentët në fokusgrupet, të cilat përbëhen kryesisht nga student me mesatare mbi 7, nga të gjitha vitet e studimit.			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Analiza dhe përpunimi i rezultateve nga instrumentat e vlerësimit finalizohet në një raport, i cili u dërgohet drejtuesve dhe shefave të departamentit. Diskutohet mbi to dhe merren masa për përmirësim, ku si masë e parë zakonisht është që përgjegjësi i departamentit thërret pedagogun, informon atë mbi shqetësimin e ngritur dhe këshillohet për mëtejje.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3
Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Institucioni kryen shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit.</p> <p>Janë përgatitur materiale dhe janë organizuar trajnime për informimin dhe ndërgjegjësimin e personelit dhe të studentëve për sigurimin e cilësisë dhe rolin e tyre në këtë proces.</p> <p>Institucioni ka hartuar dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit, duke vlerësuar didaktikat, kurrikulën, përmbajtjen e moduleve.</p> <p>Ekziston nje politikë e institucionit që sylabuset përditësohet në fillim të çdo semestri, përgjegjesi i grup lëndës bën pastaj aprovimin ose jo. Kërkohej që literatura duhet të jetë e 5 viteve të fundit, nga shtëpi botuese ndërkombetare.</p> <p>Poashtu pritet që 20% e programit të mbulohej nga ekspertë të fushës (lektorë të ftuar).</p> <p>Realizohen edhe observime gjatë orëve të mësimin, kryesisht për pedagogë të rinj, me qëllim dhënien e rekomandimeve për përmirësim të procesit të mësimdhënies.</p> <p>Bëhet edhe vlerësim i vlerësimeve të provimeve nga persona neutral, për të kontrolluar objektivitetin dhe paanshmërinë në vlerësimin e studentëve nga ana e pedagogëve të lëndëve.</p> <p>Pjesë e monitorimit të cilësisë janë edhe vlerësimet e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit - detyra kursi, projekte, punë individuale, punë në grup, si dhe vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës.</p>			
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>				
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>				
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni parashikon përfshirjen e sa më shumë aktorëve të brendshëm si përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, duke përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë për ta, që garantojnë ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.		
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në procesin e përgjithshëm për përmirësimin e cilësisë përfshihen dhe përfaqësues të studentëve.		
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Politikat e institucionit në lidhje me sigurimin e cilësisë garantojnë respektimin e etikës, integritetit akademik dhe paanshmërisë gjatë vlerësimit të personelit dhe studentëve.		
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Nga bisedat GVJ me menaxhmentin rezulton se pjesë e domosdoshme e këtij procesi është edhe përfshirja e një eksperti të jashtëm, me qëllim vlerësimin sa më objektiv të situatës së përgjithshme.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Strategjia, politika dhe të gjitha mekanizmat dhe procedurat në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë publike për studentët dhe të tjerët.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat	Institucioni publikon në mënyrë periodike raportet nga vlerësimet e ndryshme të programeve studimore, duke respektuar etikën dhe privatësinë e personelit akademik konform legjislacionit për të dhënat

personale.	personale.			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Raportet shoqërohen me mekanizma formal dhe metoda joformale (sipas rastit) që synojnë përmirësimin e mangësive që raportohen.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni analizon impaktin e masave të marra, duke u munduar që të sigurojë efektivitetin e procesit të përgjithshëm të sigurimit të cilësisë. Për këtë qëllim organizohen edhe veprimtari periodike me qëllim të informimit të studentëve dhe personelit akademik në lidhje me ndryshimet që janë bërë si rrjedhojë e kërkesave dhe rekomandimeve të tyre.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave “Informatikë ekonomike” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Europian i Tiranës.”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Mobiliteti i studentëve dhe stafit akademik në programin e studimit
2. Internshipet në kompani të mëdha në vend
3. Shërbimi ndaj studentit
4. Projektet e suksesshme ndërkombëtare ku UET është edhe lider.
5. Sistemi i brendshëm elektronik i dokumentave midis punonjësve, sistemi elektronik LMS që ka krijuar një shkëmbim shumë të shpejtë dhe transparent të informacionit midis studentëve dhe pedagogëve, sistemi elektronik UMIS që ka siguruar shkëmbimin e shpejtë dhe transparent të informacionit midis sekretarisë dhe pedagogëve.
6. NJBSC, misioni i së cilës është t'i ofrojnë studentëve një edukim cilësor nëpërmjet procesit cilësor të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor si dhe partnershipit me tregun e punës.

Pika të dobta

1. Përmbajtja e disa lëndëve nuk është mjaftueshëm e avancuar për një program studimi Master i Shkencave
2. Në këtë program studimi kanë dhënë mësim pedagogë që s'kanë gradën e duhur shkencore
3. Definim jo i qartë i kritereve të pranimit për studentë të diplomuar jashtë fushës

Rekomandime

1. Përmirësimi i përmbajtjes së syllabuseve në disa lëndë, për të ofruar njohuri më të avancuara, në përshtatje me nivelin e një program studimi Msc;
2. Rekrutimi i stafit plotësues
3. Ridefinim i kritereve të pranimit të studentëve në rregulloren e programit të studimit

Conclusions from the Evaluation of the second cycle Master of Science “Economic Informatics” at the Higher Education Institution “European University of Tirana”

Strong points and affirmations

1. Student and staff mobility in the study program
2. Internships in big companies in the country
3. Student service
4. Successful international projects where UET is also a leader

- The internal electronic file system among employees: the LMS system which has created a very fast and transparent exchange of information between students and lecturers, and the UMIS system which has ensured the rapid and transparent exchange of information between the secretary and the lecturers
- The quality assurance internal unit, whose mission is to provide students with qualitative education through a qualitative teaching and research process as well as partnerships with the labor market

Weak points

- The content of some courses is not sufficiently advanced for a Master of Science degree program
- Lecturers who do not have the appropriate scientific degree have taught in the Master of Science program
- Unclear definition of students admission criteria, for graduate students outside the field

Recommendations


- Improvement of some syllabus content, to provide more advanced knowledge in accordance with the level of a Master of Science degree program;
- Recruitment of additional staff
- Redefining the student admission criteria in the study program regulation

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Arbana Kadriu 

Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli 